

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5791  
E premte, 31 maj 2019  
çmimi 0.40 €

Thaçi: BE-ja duhet të tregohet parimore, mos ta mbajë të izoluar Kosovën **IFAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK), LËVIZJA VETËVENDOSJE (LV) DHE PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD) VAZHDOJNË PËRPPJEKJET PËR RRËZIMIN E QEVERISË **IFAQE 4-5**

## Opozita pajtohet që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme

Subjektet opozitare kanë shtuar aktivitetet për ta organizuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Për këtë qëllim, lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të enjten ka takuar edhe

kryetarin e Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, me të cilin janë pajtuar se vendit i nevojiten zgjedhje të parakohshme. Tani e tutje grupet parlamentare të opozitës do t'i bashkërendisin veprimet për rrëzimin

e qeverisë. Mirëpo, njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur skepticizëm rreth kësaj iniciative. Ata kanë vlerësuar se opozita e ka problem t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë

## Kuvendi arrin konsensus për nismën e Veselit për tribunalin për krimet e Serbisë **IFAQE 5**



Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë zhvilluar një debat për themelimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Të gjitha grupet parlamentare janë pajtuar që të

mbledhen së bashku në një komision ad hoc për t'i harmonizuar qëndrimet që më pas të votohet bashkërisht nisma për themelimin e tribunalit. Kryeparlamentari Kadri

Veseli ka thënë se është i lumtur që Kuvendi i dha drejtimin e duhur iniciativës së tij për ngritjen e tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë



**Hoxha: Krimi dhe korrupsioni janë sfidat kryesore të raportit të KE-së **IFAQE 3****

### OPINION

**KRASNOSCHENKOVI, RUS I UNMIK-ut APO RUS I GRU-së NË UNMIK? **F.12****

Burim  
RAMADANI



### AKTUALE

**RRETH 1 000 PERSONA TË PREKUR NGA SËMUNDJA E SKLEROZËS MULTIPLE **F.7****



**PRESIDENTI THAÇI: KOMUNITETET JANË PASURI E KOSOVËS **F.6****

### EKONOMI

**MIRATOHET REZOLUTA E PSD-SË PËR RITJEN E PAGËS MINIMALE **F.9****

**MINISTRIA E BUJQËSISË HAP PERIUHDHËN E APLIKIMIT PËR SUBVENCIONE ME FOND PREJ 25 MILIONË EUROSH **F.8****

### SPORT

**ARSIM THAQI: ISHTE KAMPIONAT POZITIV PËR FLAMURTARIN **F.16****

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Shqipërisë nuk i hapen negociatat, Maqedonia mund të kalojë

**BRUKSEL, 30 MAJ** - Agjencia e njohur POLITICO.eu, në një shkrim që merret me konsideratat e zgjerimit të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë, parashikon se do të ndodhë i njëjti skenar si edhe vjet. "Argumentet e Komisionit nuk i bindën të gjitha vendet anëtare as vjet dhe Franca me Holandën, efektivisht e bllokuan fillimin e bisedimeve", shkruan POLITICO. Dhe është shumë e qartë se edhe këtë herë rezultati do të jetë i njëjtë, thekson media e njohur euro-amerikane. Avokatët e hapjes së negociatave me dy vendet ballkanike argu-

mentojnë se lëvizja do të siguronte që BE-ja të mbetet një influencë e fortë në gjymtyrën e saj juglindore, përballë konkurrencës nga fuqitë e tjera, përfshirë Rusinë Kinën dhe Turqinë, vazhdon artikulli. "Por skeptikët të prirë nga Franca, argumentojnë se BE-ja nuk duhet të merret me zgjerimin deri kur të jetë reformuar për vete dhe të vetëqeveriset më me efektivitet", shton POLITICO.

Kritikët gjithashtu theksojnë korrupsionin, krimin e organizuar dhe varfërinë që karakterizojnë vendet e Ballkanit, që do të sillnin më shumë probleme në BE.

Media kujton skenën e një viti më parë kur "në një takim të ministrave të BE-së në Luksemburg qershorin e shkuar, shumica e vendeve argumentuan pro hapjes së bisedimeve me Tiranë e Shkupin. Por pozicioni i prirë nga Parisi dhe Haga, me mbështetjen e Kopenhagës, bëri që çështja të shtyhej për një vit, sepse vendimet e zgjerimit bëhen me unanimitet". Parashikimi është se një tjetër takim i Këshillit, më 18 qershor, duket se do të përfundojë në të njëjtën mënyrë-me një shtyrje të paktën me një muaj apo dy, në mos më shumë.



## Thaçi kërkon që BE-ja ta dënojë gjuhën raciste të kryeministres serbe

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kërkoj nga Bashkimi Evropian që sa më shpejt ta dënojë dhe të distancohet nga "gjuha raciste" e zyrtarëve të Serbisë, e cila, sipas tij, nxit urrejtje dhe i minon përpjekjet për pajtim dhe normalizim



**PRISHTINË, 30 MAJ** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se gjuha e përdorur nga kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, është "edhe një tjetër dëshmi e urrejtjes patologjike të regjimit aktual të Serbisë kundër qytetarëve të Kosovës".

Komentet e Thaçit vijnë një ditë pasi Bërnabiq, në prani të ambasadorit të Bashkimit Evropian në Serbi, Sem Fabrizi, tha se e shqetëson situata në Kosovë sepse, sipas saj, ka zyrtarë shtetërorë "që vërtet kanë dalë prej malit".

Thaçi kërkoj nga Bashkimi Evropian që sa më shpejt ta dënojë dhe të distancohet nga kjo "gjuhë raciste" e zyrtarëve të Serbisë, e cila, sipas tij, nxit urrejtje dhe i minon përpjekjet për pajtim dhe normalizim. "Ky veprim nuk paraqet asgjë të re dhe të jashtëzakonshme për ne, sepse ne e dimë shumë mirë karakterin gjenocidial të Serbisë së djeshme dhe asaj të sotme", tha Thaçi, ka njoftuar rfe. "Por, i

jashtëzakonshëm dhe zhgënjyes për ne është vetëm fakti i hidhur që BE-ja nuk e dënon këtë sjellje raciste dhe antievropiane të Serbisë. Përkundrazi, BE-ja vazhdon t'i mbajë dyert e hapura për një shtet që ka kryer gjenocid dhe që nuk beson në vlerat evropiane as sot", tha Thaçi.

Bërnabiq i bëri komentet të mërkurën, kur ambasadori i BE-së, Fabrizi, i dorëzoi Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. I pyetur nga Radio Evropa e Lirë, delegacioni i BE-së në Beograd nuk dëshoi t'i komentojë deklaratat e Bërnabiqit. Ajo, po ashtu, tha se disa prej udhëheqësve në Kosovë "janë edhe terroristë që nuk janë dënuar" dhe që kanë qenë të akuzuar në Tribunalin e Hagës, porse nuk janë dënuar sepse "të gjithë dëshmitarët janë vrarë".

Bërnabiq tha të enjten se nëse dikush i thotë asaj raciste, këtë e përjeton si frazë politike.

"Ata kanë dalë prej malit, sepse kanë dalë prej malit. Ata kanë qenë me uniforma në mal. Direkt nga mali janë bërë pjesë e elitës politike në Prishtinë dhe kanë nisur të udhëheqin institucione. Do të doja që të vinin nga sektori joqeveritar, por jo. Dhe, nuk mendoj se të gjithë kanë dalë nga mali. Behxhet Pacolli nuk ka dalë nga mali dhe më çudit që e ka gjetur veten në atë mes", tha Bërnabiq, në një konferencë me gazetarë në Beograd, së bashku me kryemi-

nistrin e Sllovakisë, Peter Pelegrini.

Ajo tha se ka miq shqiptarë dhe se është krenare për miqësinë me ta.

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behxhet Pacolli, përmes një postimi në "Twitter", tha se deklarata e Bërnabiqit ishte "e neveritshme dhe tërësisht e papranueshme". Sipas Pacollit, ky "racizëm i institucionalizuar" i ka rrënjët në ideologjinë e sëmurë ultranacionaliste.

Kosova dhe Serbia, qysh në vitin

2011, kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve, me ndërmjetësimin e BE-së.

Procesi i bisedimeve aktualisht ka ngecur, për shkak të, siç është thënë, taksës që u ka vënë Kosova prodhimeve të importuara nga Serbia.

Në një tjetër postim në "Twitter", Pacolli tha se nuk do të lejojë Bërnabiqin të hyjë në Kosovë përderisa ajo vazhdon me ideologjinë raciste dhe të sëmurë kundër popullit të Kosovës.

## Ambasada e ShBA-së: Shqipëria vijon të bëjë përpara me reformat

**TIRANË, 30 MAJ** - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë ka reaguar pas dhënies së rekomandimit pozitiv nga Komisioni Evropian për Shqipërinë për hapjen e negociatave. Përmes një reagimi, Ambasada amerikane e mirëpret rekomandimin e KE-së për hapjen e negociatave, si dhe konfirmimin se Shqipëria

është duke bërë përpara në zbatimin e reformave jetike dhe të pakthyeshme. "Ne mirëpresim rekomandimin e Komisionit Evropian për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe konfirmimin e saj se Shqipëria vijon të bëjë përpara në zbatimin e reformave jetike dhe të pakthyeshme. Shtetet e Bashkuara

mbeten të përkushtuara që të punojnë me partnerët tanë shqiptarë dhe të BE-së për të siguruar integritetin me sukses të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë edhe mbështetjen tonë të plotë për zbatimin në vijim të reformave legjitime dhe kushtetuese gjyqësore", thuhet në reagimin e Ambasadës amerikane.



Ministrja e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka mbajtur konferencë për medie

## Hoxha: Krimi dhe korrupsioni janë sfidat kryesore të raportit të KE-së

Korrupsioni dhe krimi i organizuar mbesin sfidat kryesore të raportit për Kosovën të Komisionit Evropian (KE). Kështu ka deklaruar të enjten ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në një konferencë me gazetarë. Ajo ka thënë se përtej deklaramëve publike duhet të bëhet më shumë në këtë drejtim në mënyrë që të ketë rezultate konkrete në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Sipas Hoxhës, në këtë raport Kosova është kritikuar për ndikime politike në drejtësi

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 30 MAJ - Ministrja e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, të enjten ka mbajtur konferencë për medie dhe ka prezantuar të gjeturat e raportit të Komisionit Evropian. Me këtë rast ajo ka bërë me dije se krimi i organizuar dhe korrupsioni janë sfidat kryesore të këtij raporti.

Hoxha ka thënë se Kosova është kritikuar edhe për ndikim politik në sistemin e drejtësisë. "Sfida mbesin korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe këtu duhet të bëjmë shumë më tepër. Përtej deklaramëve publike ne duhet të fillojmë të shohim rezultate konkrete në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Dënimet e ulëta, zvarritjet e lëndëve, kryesisht ndikimi politik në drejtësi, janë ndër kritikën e shpeshta. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë më efikas dhe më të përgjegjshëm sepse kanë paga të rritura", ka deklaruar Hoxha, duke shtuar se do të trajtohen shumë seriozisht të gjeturat e raportit të vendit. "Ne duhet të koncentrohemi në ngecjet, sfidat dhe rekomandimet që kanë dalë nga raporti për Kosovën i Komisionit Evropian. Të gjeturat, por edhe kritikën, duhet t'i marrim shumë seriozisht. Në këtë

kuadër qysh për të hënë kemi thirrur takimin e Këshillit Ndërmintor dhe aty do t'i paraqesim veprimet dhe rekomandimet konkrete për secilin ministri dhe të shohim se si dhe çfarë afatesh kohore duhet t'i zbatohet këto rekomandime në mënyrë që raporti i ardhshëm për Kosovën të jetë më i mirë", është shprehur ajo.

Ministrja Hoxha ka thënë se është më e rëndësishme që rekomandimet që kanë dalë nga raporti i vendit gjithashtu të jenë veprime konkrete në planin vjetor të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (MSA). "Gjithashtu do të veprojmë shpejt që të bëjmë një ndërlidhje sa më të mirë të rekomandimeve, gjegjësisht kritikave që dalin nga raporti i vendit, në mënyrë që të ketë një ndërlidhje me planin kombëtar për zbatimin e MSA-së", ka theksuar Hoxha.

Një çështje shumë e rëndësishme që është përmendur në raportin e vendit sipas ministres, është edhe rikonfirmimi i Komisionit Evropian se Kosova i ka zbatuar të gjitha kriteret sa i përket liberalizimit të vizave dhe tani vendimmarrja është në duart e vendeve anëtare të BE-së. Ndonëse ka bërë thirrje që sa më shpejt të merret vendimi për heqjen e vizave, ministrja Hoxha ka shprehur skepticizëm që kjo

çështje të jetë pjesë e agjendës së takimit të Këshillit të Ministrave që do të mbahet në muajin qershor. "Udhërrëfyti me 95 kriterë është plotësuar. Tani është në dorën e vendeve anëtare që të vendosin. Vendimi i Këshillit të Ministrave e përmbyll procesin e liberalizimit të vizave. Jemi duke kërkuar që liberalizimi i vizave të futet në agjendën e takimit të ministrave në qershor, por unë nuk e shoh si shumë reale që liberalizimi të jetë si një pikë e agjendës në qershor. Nuk jemi duke kërkuar asgjë më shumë sesa vlerësimin e punës sonë, sepse tani është pjesa më e rëndësishme që shtetet anëtare ta mbajnë fjalën e tyre dhe ta fusin në agjendë liberalizimin", ka thënë ajo, duke shtuar se proceduralisht kjo mund të bëhet shumë shpejt nëse ka vullnet. "Zgjedhjet sa kanë përfunduar dhe ende në institucionet e BE-së janë duke komentuar rezultatin

e këtyre zgjedhjeve, pra nuk janë duke u marrë me tema të tjera siç është hapja e negociatave apo jo për Maqedoninë e Veriut dhe për Shqipërinë. Edhe për këto dy vende raporti ka qenë shumë i qartë, pra rekomandohet hapja e negociatave. Nuk po e shohim nëse do të ndodhë kjo apo jo në qershor. Tani mbetet të shihet se a do ta fusin në agjendë edhe çështjen e këtyre dy vendeve fqinjë, por edhe çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën", ka theksuar Hoxha.

Megjithatë, sipas Hoxhës, lobimi për këtë çështje është duke vazhduar me Francën, Gjermaninë dhe shtetet e tjera. "Jemi duke lobuar dhe jemi në kontakte të përhershme, sidomos me Francën dhe Gjermaninë, por edhe me shtetet e tjera jemi duke komunikuar dhe po kërkojmë, qoftë përmes letrave të ndryshme, qoftë përmes takimeve bilaterale, një vendim-

marrje sa më të shpejtë. Ende nuk kemi një opinion qeveritar që e përfaqëson opinionin e Francës si shtet në Këshillin e Ministrave dhe derisa kjo nuk bëhet, nuk e shoh që edhe Franca edhe Gjermania do ta sjellin çështjen e vizave në agjendë të Këshillit të Ministrave pa u nderuar një konsensus i gjithëmbarshtëm. Sepse neve na nevojiten 55 për qind të shteteve anëtare që përbëjnë 65 për qind të popullsisë. Pra, patjetër na nevojiten shtetet më të mëdha si Gjermania dhe Franca", ka deklaruar ministrja Hoxha. Ajo ka sqaruar se raporti i vendit nuk është raport për liberalizimin e vizave, por për procesin e integritimit evropian. Hoxhaj ka treguar se Kosova është ende në fazën fillestare në këtë proces, pra në atë të MSA-së. "Është një raport i cili i ka të gjeturat krahas fazës ku është Kosova", ka thënë ministrja Hoxha.

## Thaçi: BE-ja duhet të tregohet parimore, mos ta mbajë të izoluar Kosovën

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten ka pranuar raportin e Komisionit Evropian për Kosovën nga shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova si shtet e ka prioritet shtetëror anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Në funksion të këtij qëllimi janë bërë shumë reforma të suksesshme, por natyrisht se ende ka sfida. Prandaj, Kosova mbetet e gatshme të bashkëpunojë dhe e përkushtuar të angazhohet për thellimin e reformave në fushat e identifikuar", ka thënë presiden-



ti Thaçi. Kreu i shtetit ka shprehur zhgënj-

imin e tij që raporti merret më shumë me taksën dhe fare pak

me vlerësimin real të fushave të caktuara. Gjuha e përdorur në raport, sipas presidentit Thaçi, e cilëson Kosovën si një shtet që pothuajse nuk ka bërë fare përparim që nga shpallja e pavarësisë.

Fraza më së shpeshti e përdorur për vlerësimin e fushave të caktuara në këtë raport është: "Kosova është në fazën fillestare/ fillestare në çdo fushë". Ky vlerësim dhe gjuha e përdorur, sipas presidentit Thaçi, nuk reflekton në mënyrë objektive situatën në vendin tonë. "Përderisa ne pranojmë kritikën dhe jemi të vetëdijshëm për sfidat", ka thënë

presidenti Thaçi, duke shtuar se nuk mund të lejohet në pafundësi trajtimin jo fer që BE-ja ka ndaj Kosovës.

Kreu i shtetit vlerëson se ky raport dekurajon vazhdimin e reformave, sidomos në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit. Duke folur për marrëdhëniet e BE-së me Kosovën, ai ka theksuar se BE-ja duhet të tregohet parimore dhe të mos e mbajë të izoluar Kosovën. Thaçi ka theksuar se liberalizimi i vizave duhet të ndodhë menjëherë dhe pa asnjë kushtëzim shtesë. Në të kundërtën, sipas tij, kredibiliteti i BE-së do të dëmtohet seriozisht.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) vazhdojnë përpjekjet për rrëzimin e qeverisë

# Opozita pajtohet që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme

Subjektet opozitare kanë shtuar aktivitetet për ta organizuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Për këtë qëllim lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të enjten ka takuar edhe kryetarin e Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, me të cilin janë pajtuar se vendit i nevojiten zgjedhje të parakohshme. Tani e tutje grupet parlamentare të opozitës do të bashkërendisin veprimet për rrëzimin e qeverisë. Mirëpo, njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur skepticizëm rreth kësaj iniciative. Ata kanë vlerësuar se opozita e ka problem t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË 30 MAJ** - Tri subjektet opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), i kanë shtuar përpjekjet rreth mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. Me qëllim të koordinimit të opozitës për rrëzimin e qeverisë, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka takuar të enjten kryetarin e PSD-së, Shpend Ahmeti. Pas takimit është thënë se ekziston pajtimi i subjekteve opozitare që vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. "Kryetari Mustafa priti në takim kryetarin e Partisë Socialdemokrate, Shpend Ahmetin, për të diskutuar për organizimin e opozitës për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë së koalicionit PAN. Ekziston pajtimi se vendit i nevojiten zgjedhje të parakohshme, për çfarë do të punohet për ta siguruar mbështetjen e nevojshme të deputetëve të opozitës, por edhe të atyre të opozitës. Grupet

parlamentare do t'i bashkërendisin veprimet për rrëzimin e qeverisë", është thënë në komunikatën për medie e LDK-së.

Edhe kreu i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka treguar se çka është biseduar në takim me liderin e LDK-së. "U takuam me z. Mustafa dhe shkëmbyem mendimet se si duhet të koordinohemi si opozitë që ta shtojmë edhe presionin opozitar, por edhe të shohim se a ka mundësi që t'i bëjmë numrat për ta rrëzuar qeverinë", ka thënë Ahmeti pas takimit. Ai ka treguar se janë pajtuar që takimet e liderëve të opozitës të vazhdojnë edhe në të ardhmen. "U morëm vesh të mbajmë takime. Iniciativa nuk është veçse 'a po vini ta rrëzojmë qeverinë'?, por kërkojmë të merremi vesh, që mocioni të jetë i suksesshëm. Besoj se do të kemi edhe takime të tjera para se të kemi një strategji finale", është shprehur Ahmeti. Javën e kaluar lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka paralajmëruar se subjekti i tij do t'i fillojë përgatitjet për mbledhjen e



nënshkrimeve për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Për këtë qëllim, Mustafa kishte takuar edhe liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Ky i fundit, pas takimit kishte vlerësuar se janë pajtuar për fillimin e përgatitjeve për rrëzimin e qeverisë. "Biseduam për situatën politike dhe iniciativën për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik e jo për korrupsion

institucional. Qytetarët duan qeverisje të re, të mirë e të drejtë dhe jo keqqeverisje që na e rrit borxhin, zhvat buxhetin dhe falimenton ndërmarrjet. U pajtuam që t'i bëjmë përgatitjet e nevojshme për rrëzimin e qeverisë", ka shkruar Kurti.

## Analistët, skeptikë për iniciativën e opozitës

Njohësit e proceseve politike

në vend kanë shprehur skepticizëm për iniciativën e subjekteve opozitare. Analistët Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala kanë vlerësuar se opozita e ka të vështirë që t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht opozita nuk është në gjendje që ta rrezikojë seriozisht pushtetin. "Iniciativa e dy partive më të mëdha opozitare për rrëzimin e qeverisë është e pamundur

të tregohen më të sinqerta dhe të tregojnë se me çfarë votash dhe si do t'i sigurojnë votat për ta rrëzuar qeverinë aktuale. Pra, nga kush synojnë t'i marrin votat e mjaftueshme", ka deklaruar Mushkolaj për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, ambicia për pushtet ka bërë që Mustafa e Kurti ta harrojnë të kaluarën dhe t'i shkelin parimet. "Edhe Mustafa dhe Kurti si duket i kanë harruar parimet dhe të kaluarën ndërmjet vete. Tash për Kurtin, Mustafa nuk është argat i Serbisë dhe për Mustafën, Kurti nuk është gomar i 'Zajednicës'. Ata i kanë humbur parimet apo po i shkelin ato për shkak të ambicies për të ardhur në pushtet. Ani pse ata po thonë se këtë po e bëjnë për të mirën e vendit dhe për ta rrëzuar një qeverisje të keqe", është shprehur Mushkolaj. Sidoqoftë, ai ka vlerësuar se kjo iniciativë do t'i shërbejë liderit të LDK-së, Isa Mustafa, për ta fuqizuar pozicionin e tij tash në prag të mbajtjes së zgjedhjeve si dhe Kurtit pas sondazheve të fundit.

Edhe analisti tjetër politik Behxhet Shala ka thënë për gazetën "Epoka e re" se opozita e ka problem që t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë. "E vetmja gjë që ka bërë opozita deri më tani ka qenë sigurimi i votave për pushtetin dhe nuk ka arritur të bëjë asgjë për rrëzimin e qeverisë. Opozita nuk po ka sukses dhe e ka problem që t'i sigurojë votat e mjaftueshme sepse PSD-ja po thotë se nuk pranon ta rrëzojë qeverinë me votat e Listës Serbe. Edhe brenda Vetëvendosjes ka të atillë që e mendojnë të njëjtën gjë, sikurse që edhe LDK-ja e ka pasur më herët këtë qëndrim. Në këto rrethana nuk ka ku t'i marrë votat e mjaftueshme. Aktualisht i kanë 56 vota, prandaj u duhen edhe pesë të tjera. Pesë vota janë shumë dhe është problem të gjenden", ka deklaruar ai, duke shtuar se shpresohet që këto vota t'i marrin nga koalicioni qeverisës.

Sipas Shalës, opozita aktuale nuk është në gjendje ta rrezikojë seriozisht pushtetin. "Që nga formimi dhe votimi në Kuvend, qeveria Haradinaj ka qenë në këmbë të qelqta dhe po bëhen gati dy vjet të funksionimit të saj. Prandaj iniciativa e opozitës nuk besoj se do të japë rezultat. Sipas mendimit tim, opozita nuk është në gjendje ta rrezikojë seriozisht pushtetin", ka theksuar Shala.

Përpjekjen e opozitës për rrëzimin e qeverisë nuk e kanë marrë seriozisht as partnerët e koalicionit qeverisës. Sipas partive në pushtet, iniciativa e opozitës është joserioze sepse nuk i ka votat e duhura për rrëzimin e qeverisë.

# Kuvendi arrin konsensus për nismën e Veselit për tribunalin për krimet e Serbisë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë zhvilluar një debat për themelimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Të gjitha grupet parlamentare janë pajtuar që të mblidhen së bashku në një komision ad-hoc për t'i harmonizuar qëndrimet që më pas të votohet bashkërisht nisma për themelimin e tribunalit. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se është i lumtur që Kuvendi i dha drejtimin e duhur iniciativës së tij për ngritjen e tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINE, 30 MAJ** - Kuvendi i Kosovës të enjten ka rritur të gjejë konsensus rreth nismës së kryetarit Kadri Veseli për themelimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Të gjitha grupet parlamentare janë pajtuar që të mblidhen së bashku, në një komision ad-hoc, për t'i harmonizuar qëndrimet që më pas të votohet bashkërisht nisma për themelimin e tribunalit.

Grupet parlamentare do t'i harmonizojnë qëndrimet edhe rreth Ditës së Gjenocidit, ndërtimit të Muzeut të Gjenocidit dhe Muzeut të Debimit. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se është i lumtur që Kuvendi i Republikës së Kosovës i dha drejtimin e duhur iniciativës për ngritjen e tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë. "Duke votuar një komision konsensual që do të merret me këtë nismë dhe me rekomandimet e tjera për Muzeun e Gjenocidit, Muzeun e Debimit dhe shpalljen e Ditës së Gjenocidit, falënderoj të gjithë deputetët. Ky tribunal është i domosdoshëm, i pashmangshëm dhe ai do të ndodhë", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se nuk është me rëndësi se kush është iniciues i kësaj çështjeje

por, sipas tij, me rëndësi është që të formohet një tribunal i tillë.

Edhe gjatë seancës të së enjtes ka pasur diskutime e kundërshtime për çështjen e themelimit të tribunalit ndërkombëtar. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se tribunali ndërkombëtar për krimet e Serbisë në Kosovë merr shumë kohë dhe kjo shkon në favor të shtetit të Serbisë. Sipas tij, derisa të nisë puna e tribunalit, do të vdesin edhe dëshmitarët. "Të flasësh për tribuna ndërkombëtare nuk do të thotë të ngutësh. Do të thotë përkundrazi të mos ngutësh. Ideja për tribunal ndërkombëtar i jep kohë Serbisë, i jep kohë kundërshtarit tonë. Pra, në kundërshtim me atë që proklamohet nga kreu dhe zëdhënësit e tjerë të PAN-it, ideja e nxituar për tribunal i jep më shumë kohë Serbisë se do të kalojnë shumë vjet derisa të themelohet dhe të fillojë funksionimi i një tribunalit të tillë. Me këtë ide, Serbisë i sigurohet se edhe për një dekadë nuk do ta gjejë gjë", ka thënë Kurti në Kuvendin e Kosovës.

Më 6 maj, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur edhe formalisht procedurat për iniciativën për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Ndërkaq, një

ditë më vonë, më 7 maj, Komisioni parlamentar 'ad-hoc' për hartimin e Projektrezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë, ka miratuar një draft-rezolutë.

Profesori i së drejtës penale ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka mbështetur iniciativën e kryeparlamentarit Kadri Veseli për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe, duke thënë se një gjë e tillë është e mundshme. "Kjo iniciativë duhet të mbështetet nga institucionet dhe gjithë të tjerët. Në 20 vjetët e fundit ky është njeriu që më së tepërmi tani ka filluar një punë shumë të rëndësishme dhe serioze, të cilën e bën çdo udhëheqës i kombeve pas luftës. Kjo është dashur të bëhet më herët, ani pse duket pak ideale me angazhimin e resurseve humane dhe profesionale të cilat i ka Kosova në aspektin profesional", ka thënë Salihu.

Edhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se askujt prej partive politike nuk i takon që të deklarohet se mund apo nuk mund të themelohet tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se spektri politik shqiptar duhet të jetë unik rreth gjenocidit serb në Kosovë dhe themelimit të tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë.



në rast se nuk sigurohen edhe disa vota nga koalicioni qeverisës. Është interesante se kjo iniciativë ka ardhur pikërisht në këtë kohë, ani pse është bërë më shumë se një vit prej se kemi këtë qeveri dhe këtë mënyrë të qeverisjes së kryeministrit Haradinaj. Deri më tani as LDK-ja dhe as Vetëvendosja nuk kanë bërë diçka konkrete në këtë drejtim. Megjithatë, kjo duket shumë e dyshimtë sepse LDK-ja dhe LV-ja duhet



# Presidenti Thaçi: Komunitetet janë pasuri e Kosovës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 MAJ - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të enjten ka mbledhur Këshillin Konsultativ për Komunitete. Thaçi i ka përgëzuar anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete për angazhimin e vazhdueshëm për përmirësimin e kornizës ligjore, për t'i promovuar dhe mbrojtur edhe më mirë të drejtat e komuniteteve. "Ju falënderoj që vazhdimisht i keni ngritur shqetësimet e komuniteteve të Kosovës. Si president i vendit e mbështes punën tuaj dhe jam i kënaqur me bashkëpunimin që kemi ndërtuar deri më tani. Prioriteti im është që ta inkurajoj dialogun e brendshëm në Kosovë. Kjo vlen edhe për dialogun në mes të komuniteteve të Kosovës si mënyra më e mirë për t'i avancuar dhe mbrojtur të drejtat e të gjitha komuniteteve", është shprehur presidenti Thaçi. Këto ditë, derisa shënojmë 20-vjetorin e intervenimit të NATO-s dhe përkujtojmë viktimat e para dy dekadave, presidenti Thaçi ka theksuar se të gjithë bëhemi edhe më të vetëdijshëm për tragjeditë që sjellë lufta dhe konflikti. "Kjo na bënë edhe më të vendosur dhe më këmbën-

gulës në dialog në mes të të gjitha komuniteteve, të cilat janë pasuri e Kosovës. Forumi si ky i juaji është shtyllë e ndërtimit të paqes dhe stabilitetit në rajon. Shtyllë e bërjes së Kosovës shtëpi e përbashkët për të gjitha komunitetet", ka deklaruar ai.

Thaçi ka theksuar se e përcjellë me vëmendje gjendjen e komuniteteve në Kosovë. "Dje pata kënaqësinë të marr pjesë në hapjen e Qendrës Zhvillimore të Komunitetit Malazez në Kosovë. Kam pasur kënaqësinë t'ju pres në zyrë apo të vij tek ju në shënimin e Ditës Kombëtare për secilin komunitet. Mesazhi nga të gjitha këto takime është se Kosova është shtëpi e të gjitha komuniteteve të saj. Dhe se të gjitha institucionet e shtetit të Kosovës janë të përkushtuara për përkrahjen dhe promovimin e të gjitha komuniteteve", ka thënë presidenti.

Duke e lexuar Raportin e Progresit të publikuar të mërkurën, presidenti Thaçi ka thënë se në pjesën për të drejtat e njeriut në Kosovë vërehet se ka përmirësim të dukshëm për ndërtimin e infrastrukturës ligjore. "Tani fokusi duhet të jetë në përmirësimin e implementimit të kësaj infrastrukture. Ju ftoj të luani rol aktiv duke u angazhuar për monitorim dhe



raportim të implementimit të të gjitha provizioneve për t'i garantuar të drejtat e përgjithshme në Kosovë", ka thënë Thaçi.

Anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete, në anën tjetër, e kanë njoftuar presidentin Thaçi me të arriturat dhe shqetësimet e komuniteteve të tyre. "Siguria dhe zhvillimi ekonomik janë shqetësimet

kryesore të të gjithë qytetarëve", kanë konstatuar ata.

Presidenti Thaçi ka mirëpritur kontributet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe i ka ftuar ata për vazhdim të bashkëpunimit. "Kosova është shtëpia që e ndërtojmë së bashku", është shprehur presidenti Thaçi. Në takim me anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete,

kreu i shtetit e ka dënuar ashpër edhe sulmin e djeshëm ndaj një gruaje në Lipjan, për të cilën papërgjegjshëm dhe padrejtësisht u raportua në mjetet e informimit se është e përfshirë në veprime kriminale. "Në Kosovë nuk ka vend për dhunë, nuk ka vend për sulme kundër askujt, nuk ka vend për paragjykim", ka theksuar Thaçi.

## Nxënësit e shkollës shqipe nga Sllovenia vizitojnë Kosovën



PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, nxënës të shkollës shqipe të Sllovenisë po qëndrojnë për një vizitë katërditore në Kosovë. Të enjten ata janë pritur në Ministrinë e Diasporës nga zëvendësministri Isni Kilaj, i cili është shprehur i lumtur që po takon nxënës dhe mësues që janë të interesuar ta ruajnë kulturën, gjuhën dhe traditën shqiptare. Duke iu uruar mirëseardhje në emër të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Diasporës,

Dardan Gashi, Kilaj ka thënë se me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të lidhjeve me Kosovën, MDIS-i mbështet dhe organizon vizita të tilla për nxënësit shqiptarë nga diaspora. "Qëllimi i ministrisë është që përmes organizimeve si ky sot, por edhe të tjerave, t'i mbani kontaktet me atdheun për ta ruajtur gjuhën, kulturën e traditën", është shprehur zëvendësministri Kilaj. Ndërkaq mësimdhënëset dhe nxënësit e falënderuan Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve

Strategjike, në veçanti ministrin Dardan Gashi, i cili ka mundësuar krijimin e lidhjeve ndërmjet bashkatdhetarëve nga Sllovenia. Ata theksuan se komuniteti shqiptar në Slloveni kurrë më parë nuk kishte një lidhje kaq të afërt me Kosovën. Në ditën e dytë në Kosovë ata do ta vizitojnë edhe një shkollë të Mushtishtit të Suharekës, ku do të mbahet orë e përbashkët mesimi dhe do të jepet një program kulturor. Më pas, do ta vizitojnë memorialin "Adem Jashari" në Prekaz.

## Kuvendi miraton Projektligjin për RTK-në

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë miratuar të enjten në lexim të parë Projektligjin për Transmetuesin publik. Në favor të tij kanë votuar 61 deputetë, 55 prej tyre për, një kundër dhe pesë kanë abstenuar. Pas këtij votimi, drejtori i RTK-së, Ngadhajm Kastrati, ka thënë se votimi në parim i Ligjit për Transmetuesin Publik nga deputetët i hapë rrugë miratimit në tërësi të këtij ligji. "Miratimi i Ligjit të RTK-së do

t'i hapë rrugë zhvillimit të RTK-së duke filluar nga financimi adekuat i cili do ta ndihmonte ecurinë nëpër të cilën po kalon Transmetuesi Publik e deri te zgjidhja e çështjes së pronës", ka thënë Kastrati, duke shtuar se si drejtor i këtij mediumi është i gatshëm të ndihmojë në amendamentimin e Ligjit të RTK-së për leximin e dytë, duke ofruar edhe asistencë nga ekspertët e Unionit Evropian të Transmetuesve. Edhe kryetarja e Bordit të RTK-së, Afërdita Malqi, ka

thënë se ky dokument ka rënësi jetike për funksionim e RTK-së. "Ky është një hap shumë pozitiv për vendin, duke ditur se Media e Shërbimit Publik (MShP) është pranuar nga BE-ja si pjesë integrale e zhvillimit dhe lirisë së medieve në kapitujt 23/24 dhe në kapitullin 10 të Raportëve të Progresit të Komisionit Evropian në kuadrin e negociatave mbi progresin e vendeve në procesin e anëtarësimit në BE", ka thënë ajo, duke shtuar se ky ligj rëndësi të veçantë ka për punë-



torët e RTK-së, të cilët punojnë në kushte jo të dinjitetshme. "Duke i falënderuar deputetët e Kuvendit që votuan sot, ne zotohemi se do

të bashkëpunojmë ngushtë edhe gjatë trajtimit të këtij Projektligji në lexim të dytë", ka thënë Malqi.

# Sheshit 'Fehmi Lladrovci' iu shtuan shtatorja e Rasim Kiçinës dhe e Bedri Shalës



**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**DRENAS, 30 MAJ** - Të enjten në Drenas është përvuar shtatorja e heroit Rasim Kiçina dhe e Bedri Shalës. I pranishëm në zbulimin e këtyre shtatoreve ishte edhe presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari dhe ai i Drenasit, Ramiz Lladrovci, deputetë dhe përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se këta dy heronj përfaqësojnë dy figura tipike të luftëtarëve që i krijoi Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

"Përfaqësojnë figurën e brezit të rinisë atdhetare brenda Kosovës që iu bashkua luftës çlirimtare

me ndërgjegje të lartë dhe pa hezitim, nga njëra anë, dhe atë që nga bota e jashtme u kthye në atdhe drejt në frontet e luftës. Pra, të dy i bashkoi lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", është shprehur presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se Bedri Shala e la mirëqenien në botën perëndimore dhe iu përgjigj thirrjes për të luftuar me pushkë në dorë. "Luftoi për ideal me të cilat ishte rritur dhe edukuar në familjen e tij, që brez pas brezi ishin rreshtuar nga fati i kombit. Bedriu nuk kurseu asgjë në shërbim të luftës për liri. Ishte kudo. Sa ishte në front, sa në udhëtime rraskapitëse për furnizim me armatim, sa në stërvitje të

ushtarëve të rinj, aq edhe në beteja. Bedriu ra në mbrojtje të Junikut më 10 gusht 1998, duke mbyllur kapitullin e jetës mender dhe heroizëm", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa për Rasim Kiçinën, presidenti Thaçi ka theksuar se ishte një ndër pjesëtarët e njësiteve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe hyn në radhën e figurave më të shquara që dha historia e ndritur e luftës sonë për liri. "Beteja te Lisat Gjashtënjak në Likoshan, betejat e Brigadës 111 'Adem Jashari' dhe shumë luftime të tjera më 1998 dhe 1999 janë të lidhura ngushtë me shpirtin luftarak dhe guximin e Rasim Kiçinës. Rënia e tij 20 vjet më parë ishte ndër humbjet më të mëdha të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Thaçi. Ai ka theksuar se Rasimi dhe Bedriu ishin sinonim i luftëtarit të lirisë, prijësit dhe shpirtit sakrifikes. "Pa luftën e drejtë të UÇK-së, pa sakrificën e mijëra dëshmorëve dhe martirëve, pa përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të shteteve të BE-së dhe NATO-s, Kosova nuk do të ishte ajo që është sot, shtet i lirë dhe sovran. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte projekti më serioz politik dhe ushtarak i kombit shqiptar", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit ka shtuar se për aq sa po kalon koha, aq më shumë po dalin në dritë madhështia dhe pastërtia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Luftën dhe

sakrificën për liri nuk mund ta njollosë askush", ka thënë Thaçi, duke shtuar se Kosova së shpejti do ta shënojë 20-vjetorin e çlirimit. "Kosova po hyn në dekadën e dytë të lirisë, por ende plagët e luftës nuk janë shëruar. Shteti i Serbisë ushtroi gjenocid, spastrim etnik, vrasje dhe masakra anembanë Kosovës. Ende askush nga urdhërhënësit dhe ekzekutorët e krimeve mbi popullatën civile të Kosovës nuk doli para drejtësisë vendore ose ndërkombëtare. Por, krimi dhe gjenocidi nuk vjetrohen asnjëherë", është shprehur presidenti. Thaçi ka theksuar se këto dy shtatore madhështore e pasurojnë edhe më shumë Sheshin "Fehmi Lladrovci".

## Rreth 1 000 persona të prekur nga sëmundja e sklerozës multiple

Të enjten në Prishtinë është shënuar Dita Botërore e Sklerozës Multiple, ku edhe është bërë thirrje për më shumë mbështetje institucionale për të prekurit nga kjo sëmundje. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se institucionet vendore do të bëjnë gjithçka për të siguruar buxhet, me të cilin do të mbulohej kostoja e trajtimit të sklerozës multiple

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 30 MAJ** - Në Kosovë u shënuar Dita Botërore e Sklerozës Multiple, gjersa u theksua nevoja për më shumë mbështetje institucionale për të prekurit nga kjo sëmundje. Skleroza multiple prek trurin dhe palcën kurrizore, duke e shkatërruar mbështjellësin e fijeve nervore.

Simptomat e zakonshme të kësaj sëmundjeje janë: çrregullimi i shikimit, dhembja dhe mpirja e gjymtyrëve,

vështirësitë në koordinim, dobësimi i muskujve, lodhja, çrregullimi i disponimit dhe çrregullimi në jashtëqitje dhe urinim.

Kryetari i Shoqatës së Neurologëve të Kosovës, dr. Afrim Blyta, ka thënë se ka ardhur koha që me angazhimin e të gjitha strukturave vendimarrëse, të bëhet më shumë për sigurimin e terapisë bashkëkohore për trajtimin e sklerozës multiple. "Me energjinë që ekziston sot në vendimmarrje dhe me iniciativën që është marrë nga ana e profesionistëve



në sistemin shëndetësor, një iniciativë për trajtimin e kësaj sëmundjeje do të realizohet me sukses në interes të përgjithshëm të pacientëve që kanë nevojë për ndihmën tonë", ka thënë Blyta.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka theksuar se institucionet vendore do të bëjnë

gjithçka për të siguruar buxhet, me të cilin do të mbulohej kostoja e trajtimit të sklerozës multiple. "Ministria e Shëndetësisë, përmes hartimit të koncept-dokumentit për sëmundjet e rralla, tashmë ka nisur hapat konkretë për zgjidhjen e problemit të tyre. Ndërkaq, në listën e re të barnave esenciale jemi

angazhuar që të përfshijmë një numër sa më të madh të produkteve për të prekurit nga kjo sëmundje që ta zbusim barrën e madhe financiare që kanë pasur për shumë vite ata", ka thënë Ismaili.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka falënderuar mjekët për punën, ndërsa ka premtuar mbështetje të pakursyer nga menaxhmenti, në mënyrë që trajtimi i sklerozës multiple të jetë sa më i suksesshëm. "Ne si menaxhment i ShSKUK-së do të ofrojmë mbështetje të përzërvë për stafin shëndetësor, me qëllim që diagnostikimi i personave që vuajnë nga kjo sëmundje, të bëhet sa më herët dhe trajtimi të jetë më i suksesshëm", ka thënë Sejdiu.

Në Kosovë nga kjo sëmundje llogaritet të jenë prekur rreth 1 000 persona.

# Ministria e Bujqësisë hap periudhën e aplikimit për subvencione me fond prej 25 milionë eurosh

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur të enjten fazën e aplikimit për pagesa direkte/subvencione për disa kultura dhe aktivitete bujqësore. Për sektorët të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2019, MBPZHR-ja ka ndarë një buxhet prej 25 milionë eurosh dhe afati për aplikim për këtë program fillon nga sot dhe përfundon më 30 qershor 2019.

Ministria e Bujqësisë në programin e sivjetmë ka paraparë subvencione për sipërfaqet e mbjella të grurit, të farës së grurit, të elbit, të thekrës, të tërshërës, të misrit, të lulediellit, për vreshtat ekzistuese, verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, për pem-

ishtet ekzistuese, për sasinë e dorëzuar/shitur të frutave të mjedrës, për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegetative, për sipërfaqet e mbjella me perime, për bujqësi organike, për lopë dhe buallica qumështore, dele, dhi, bletë, për pula vojse, për thëllëza, për dosa në riprodhim, për primin e sigurimit bujqësor për kulturën bujqësore të mjedrës, për sasinë e dorëzuar/shitur të duhanit.

Për më shumë informata, lidhur me procedurat e aplikimit për pagesa direkte, kriteret e vlerësimit, fermerët mund të informohen në detaje në uebfaqen e ministrisë dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.



## Miratohet rezoluta e PSD-së për rritjen e pagës minimale



PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Rezoluta e Partisë Socialdemokrate (PSD) për rritjen e pagës minimale ka kaluar me shumicë votash të enjten në Kuvendin e Kosovës. Pro kësaj rezolute kanë votuar 62 deputetë, asnjë kundër dhe një abstenim. PSD-ja vazhdimisht ka kërkuar që paga minimale që është 130/170 euro të rritet në 250 euro. Ndërsa kryetari i kësaj partie, Shpend Ahmeti, pas votimit të kësaj rezolute, i ka bërë thirrje ekzekutivit që sa më shpejt t'i ndër marrë hapat për implemen-

timin e rezolutës ku asnjë qytetar i Republikës së Kosovës nuk bën të paguhet nën 250 euro.

Ndërkaq deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se paga minimale aktuale që është 130/170 euro, duhet patjetër të rritet në 250 euro. Ai ka thënë se pas kësaj rezolute beteja e grupit parlamentar të kësaj partie është rritja e numrit të inspektorëve të punës, në mënyrë që të respektohen të drejtat e punëtorëve ashtu siç parashihen me ligjet në fuqi. "Ne jemi të vetëdijshëm

që edhe kjo shumë nuk është e mjaftueshme, por nga pozicioni i opozitës nuk mund ta rrisim më shumë. Megjithatë, ekonomia e shumë punëtorëve dhe familjeve do të preket dukshëm nga kjo rritje. Beteja jonë e radhës është rritja e numrit të inspektorëve të punës, në mënyrë që të respektohen të drejtat e punëtorëve ashtu siç parashihen nga ligjet në fuqi. PSD-ja nuk do të ndalet me veprimet e saj konkrete që ua ndryshojnë jetën qytetarëve për të mirë", ka thënë Molliqaj.

## OAK-u përshëndet mosvotimin e Projektligjit për Miniera dhe Minerale

PRISHTINË, 30 MAJ (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka përshëndetur mosvotimin e sërishëm të Projektligjit për Miniera dhe Minerale në seancën e së enjtes në Kuvend, duke kërkuar që ky projektligj përfundimisht të rikthehet në Komision Parlamentar për ndryshimet e kërkuara. "OAK-u së bashku me bizneset e këtij sektori ka zhvilluar deri me tani dhjetëra aktivitete qoftë në tryeza me biznese, institucione dhe deputetë që nga fillimi, që ky projektligj të mos votohet në gjendjen aktuale, duke dhënë arsye të forta në lidhje me këtë të cilat iu janë drejtuar edhe me shkrim disa here. Kujtojmë se ky projektligj ka më shumë se një

vit që është në parlament dhe kjo përpjekje e sotme është një nga përpjekjet e shumta që janë bërë për ta votuar këtë projektligj", thuhet në reagimin e OAK-ut.

Qëllim kryesor i këtyre kërkesave është krijimi i lehtësirave për këtë sektor që konsiderohet një nga sektorët më me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit.

Oda e Afarizmit të Kosovës kërkon me insistim që Projektligji për Miniera dhe Minerale të rikthehet edhe një herë në Komision Parlamentar, duke e konsideruar që ky rikthim do të jetë mjaft frytdhënës, në mënyrë që edhe miratimi i ligjeve të bëhet në përputhje të nevojave të bizneseve.





# Komisioni Evropian vlerëson se mungesa e rrymës është pengesa kryesore e zhvillimit të Kosovës

Sipas raportit të Komisionit Evropian, Kosova ka dështuar t'i zvogëlojë humbjet në rrjetin e energjisë elektrike derisa kapacitetet aktuale prodhuese të energjisë elektrike vlerësohen të pasigurta

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 MAJ - Rryma e pasigurt dhe problemet me prodhimin dhe furnizimin e parregullt me energji elektrike në vend janë sfidat kryesore për zhvillimin ekonomik të Kosovës, sipas Raportit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian.

Sipas raportit, Kosova ka dështuar t'i zvogëlojë humbjet në rrjetin e energjisë elektrike derisa kapacitetet aktuale prodhuese të energjisë elektrike vlerësohen të pasigurta. "Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa për t'u bashkuar me tregun e Shqipërisë për shkëmbim të energjisë, por linja e re e transmisionit me Shqipërinë

ende nuk është operacionale për shkak të mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kosova nuk ka infrastrukturë të gazit", thuhet në raportin e Komisionit Evropian.

Sipas këtij raporti, problemet e furnizimit me energji elektrike janë vlerësuar sfidë kryesore e të bërit biznes edhe nga vetë bizneset. Raportet e anketimit të USAID-it theksojnë se bizneset humbin mbi 300 milionë euro në vit për shkak të furnizimit jo të rregullt me energji elektrike. "Qeveria ka nënshkruar marrëveshje komerciale me tenderuesin për ndërtimin e Termocentralit 'Kosova e Re', me

kapacitet prej 500 megavatësh, ndërtimi i të cilit do të fillojë në vitin 2019", thuhet në raport. Sipas Raportit të Progresit, Kosovës i duhet t'i fillojë përgatitjet për dekomisionimin e njësive të 'Kosovës A', duke përfshirë edhe identifikimin e lokacionit për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme të këtij termocentrali, derisa rekomandohet edhe ndërmarrja urgjente e investimeve në Kosovën B, me qëllim të zvogëlimit të vlerave të ndotjes. "KEK-u duhet ta përcaktojë orarin e të gjitha punëve në kuadër të asistencës së planifikuar të BE-së për renovimin e Kosovës B, në

mënyrë që ajo të jetë në përputhje me dispozitat e direktivës për emetimet e pluhurit dhe NOx", thuhet në raport.

Sipas strategjisë energjetike të Kosovës, pas dekomisionimit të Termocentralit "Kosova A", Termocentrali "Kosova e Re" do të ofrojë kapacitete të mjaftueshme për furnizim të rregullt me energji elektrike. Përveç të tjerash, termocentrali do të sigurojë furnizim dhe pavarësi energjetike për Kosovën. Termocentrali i ri i paralajmëruar i Kosovës, përmes zvogëlimit të ndotjes, do t'i plotësojë të gjitha standardet e përcaktuara të Komisionit Evropian.



## Vlerësohet Portali i Transparencës së Ministrisë së Financave

PRISHTINË, 30 MAJ (ER)- Në kuadër të Menaxhimit të Financave Publike, Komisioni Evropian në Raportin për Kosovën 2019, vlerëson Portalin e Transparencës së Ministrisë së Financave" <https://ptmf.rks-gov.net/>, i cili në një format më

të përdorshëm dhe të lexueshëm, ka ndikuar në rritjen e transparencës buxhetore për institucionet qendrore dhe ato komunale.

Me këtë rast, ministri i Financave Bedri Hamza ka shprehur përkushtimin për

avancimin e mëtutjeshëm të sistemit të portalit të transparencës së Ministrisë së Financave, në funksion të transparencës buxhetore dhe informimit më të mirë të qytetarëve të Kosovës për shpenzimin e parasë publike.



## Deçani përkujton 9 dëshmorë dhe 13 martirë

DEÇAN, 30 MAJ (ER) - Në nderim të nëntë dëshmorëve dhe trembëdhjetë martirëve të rënë në altar të lirisë, kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, nënkryetari Sami Cacaj, koloneli Abdyl Mushkolaj, zyrtarë të policisë, FSK-së, komunalë, bashkëluftëtarë, familjarë dhe

qytetarë të shumtë, kanë vendosur kurora me lule dhe janë përlurur para lapidarit të dëshmorëve ku skaliten emrat e tyre në qytetin e Deçanit. Ramosaj ka thënë se heroizmi i tyre do të shërbejë si burim për fuqizimin e shtetit të Kosovës. "Luftës sonë për liri e dinjitet këta djem trima ia shtuan

pushkët e tyre për të rënë në mbrojtje të së drejtës sonë. Heroizmi i tyre do të na shërbejë përherë si burim për fuqizimin e shtetit të Kosovës. Kështu u tha gjatë këtyre homazheve. Vepra atdhetare e tyre, shëmbëlltyrë për breza. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Ramosaj.



## PDK-ja: Papërgjegjësia e komunës ka lënë qytetarët e Fushë-Kosovës pa ujë të pijshëm

FUSHË KOSOVË, 30 MAJ (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Fushë-Kosovë, Rrahim Ternava, ka thënë se neglizhenca dhe papërgjegjësia e komunës tash e 20 vjet ka lënë qytetarët pa ujë të pijshëm. Këto kritika në drejtim të Komunës së Fushë-Kosovës, Ternava i bëri gjatë një takimi me kryeshefin e KUR Prishtina, Ilir Avdullahu, ku diskutuan rreth problemit me ujë të qytetarëve të kësaj komune.



Kosovë, Rrahim Ternava, ka thënë se qytetarët deri më tash janë ndjerë të diskriminuar. Ai ka theksuar se PDK-ja do të

angazhohet fuqishëm që projekte si ky të mos zvarriten. "Kjo situatë është e papranueshme dhe diskriminuese për qytetarët e Fushë-Kosovës. Komuna tash e 20 vjet ka lënë pa ujë qytetarët e vet për shkak të papërgjegjësive që i shquan. Ne si opozitë në këtë komunë do të jemi zë i fortë që projekte të tilla t'i shtyjmë përpara dhe nuk do të lejojmë që neglizhencën e komunës ta vuajnë qytetarët", ka thënë Ternava.

Edhe kryeshefi ekzekutiv i KUR Prishtina ka thënë se mjetet

financiare janë bërë shkak i vonesave për shtrirjen e ujësjellësit. "Mosgatishmëria e komunës për përkrahje financiare dhe ofrimi i kushteve të tjera ka bërë që implementimi i këtij projekti të shtyhet, por ne jemi të gatshëm dhe shumë shpejt do të finalizohet ky projekt", është shprehur Avdullahu. Fushë-Kosova është pothuajse e vetmja komunë ku një pjesë e qytetit nuk ka furnizim të ujit të pijshëm, ndërkaq sistemi i ujësjellësit tek tash ka arritur në fazën finale.

## Në Universitetin 'Kadri Zeka' mbahet sesioni informues ERASMUS+

GJILAN, 30 MAJ (ER) - Universiteti "Kadri Zeka", në Gjilan në bashkëpunim me partnerët e ERASMUS + dhe Zyrën e Erasmus + në Prishtinë, në kuadër të konferencës së parë DiGiDay 2019 ka organizuar sesionin informues.

Ky sesion informues është organizuar me qëllim të prezantimit të projekteve ndërkombëtare që zhvillohen në UKZ, aktivitetet që ndërmerren, partnerët, përfitimet si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me universitete dhe organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit. Me këtë rast, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi, pasi ka përshëndetur të pranishmit, njëherësh ka uruar për fillim të mbarë të

konferencës DIGIDAY.

Rektori duke folur për programet e Erasmus +, ka thënë se projektet e tilla janë të mirëseardhura për universitetin si për studentët, po ashtu për stafin akademik e administrativ, pasi janë mundësi e mirë e krijimit dhe përmirësimit të mësimnxënies dhe mësimdhënies, thellimit të njohurive rreth çështjeve të ndryshme duke i harmonizuar me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së.

Rreth prezantimit të punës në projekte ndërkombëtare dhe rreth aktivitetet të tjera gjatë këtij sesioni të pranishmit janë informuar nga prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ, Dukagjin Leka, i cili ka paraqitur veç e veç projektet



ndërkombëtare të UKZ-së, projektet e Erasmus + (GreenTech, EUFORIA, REBUS, SMAHPC, E-

Viva) Në ndërkohë janë shpërndarë certifikata nga projekti Erasmus +

REBUS për studentët e UKZ-së të cilët kanë marrë pjesë në trajnimin dyjavor në Grac të Austrisë.

## Nënshkruhet kontrata nga e cila përfitojnë 70 biznese ferizajase

FERIZAJ, 30 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, dhe përfaqësuesi i Fondacionit Kosovo - Luxembourg, Fisnik Rexhepi, kanë nënshkruar një kontratë nëpërmjet së cilës do të bëhet bashkëfinancimi i së paku 70 bizneseve fillestare dhe ekzistuese që operojnë në këtë komunë për një periudhë të përkohshme. Kjo kontratë kap vlerën e mbi 200 mijë euro dhe ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të bizneseve,

gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Komunën e Ferizajt. Për këtë rast, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se kjo kontratë do të ketë ndikim në ekonominë lokale, duke fuqizuar biznesin dhe gjeneruar vende të reja të punës.

Ndërsa përfaqësuesi i Fondacionit Kosovo - Luxembourg, Fisnik Beqiri, ka thënë se përmes kësaj kontrate përmbushet një synim i kësaj

organizate që për mision ka fuqizimin e bizneseve fillestare dhe ekzistuese përmes kësaj forme mbështetjeje. Përfitues nga kjo kontratë do të jenë bizneset ferizajase të cilat do të mbështeten me fonde në formë të pajisjeve të nevojshme për fushë veprimtarinë e biznesit të tyre. Është theksuar se nismat e tilla janë hapa të rëndësishëm për përmbushjen e objektivave që burojnë nga platforma qeverisëse në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.



# Krasnoschenkovi, rus i UNMIK-ut apo rus i GRU-së në UNMIK?



**Burim RAMADANI**

Sipas raportimeve, zyrtari i UNMIK-ut, Mikhail Aleksandrovich Krasnoschenkov, është arrestuar në Zubin Potok duke e përdorur makinën e vet zyrtare të UN-it për ta penguar Njësitin ROSU të Policisë së Kosovës për t'i kryer detyrat e parapara.

Policia e Kosovës ka pasur për detyrë t'i arrestojë disa kosovarë të dyshuar për përfshirjen në rrjetin e kontrabandës që u ekspozua pas një hetimi njëvjeçar. Pra, të dyshuarit për

kontrabandë dhe jo për etninë e tyre.

Fjalët e mediave serbe e ruse, se Krasnoschenkov ishte një kalimtar i pafajshëm, i cili u kap në përpjekjet e PK-së për ta thyer bllokadën rrugore, janë shumë të dyshimta. Atëherë, pse Krasnoschenkov qëllon atje në vendin e ngjarjes, apo pse nuk u largua kur e pa pengesën? Pse përdori automjetin e tij zyrtar për ta bllokuar rrugën, pse i rezistoi arrestimit, ose a ekzistonte ndonjë agjendë tjetër që kishte Krasnoschenkov e që ishte e fshehur nga UNMIK-u?

Burime të besueshme pretendojnë që Krasnoschenkov jetoi një jetë krejtësisht ndryshe para se të punësohej në Kombe të Bashkuara dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE). Krasnoschenkov, një kolonel i pensionuar i

ushtrisë ruse, më 1990 ka punuar në zyrat e Atasheut të Mbrojtjes në Azinë Juglindore. Në vitin 1990 ishte e zakonshme që të gjithë anëtarët e atasheve ushtarakë ruse ishin pjesë e Drejtorisë Kryesore të Inteligjencës ruse (GRU).

Inteligjenca Ushtarake Ruse, e njëjta GRU që e mbajti përgjegjësinë për përpjekjen e dështuar në grushtshtetin në Malin e Zi në vitin 2016.

Nëse nuk ishte e qartë më parë, është e qartë tani që qeveria ruse po përpjeket t'i ushqejë tensionet etnike me qëllim të minimimit të sovranitetit të Kosovës dhe prishjen e çdo mundësie në Kosovë dhe Serbi për t'i normalizuar marrëdhëniet e tyre, duke e mbajtur bashkësinë ndërkombëtare dhe misionet e tyre në Kosovë.

Rusia nuk do të ndalojë me kaq,

madje edhe duke shkelur ligjin, për ta arritur misionin e saj për ta ndarë Kosovën në linja etnike.

Nuk është ndonjë sekret se Rusia po përpjeket ta manipulojë anëtarësimin e saj në organizata të ndryshme për t'i fshehur oficerët e tyre të zbulimit dhe të bashkëpunësorëve. Duhet vetëm të shikohet arrestimi i fundit i punonjësit të UNMIK-ut, Iana Minochkina, e cili në pjesën e jashtme dukej se ishte duke vjedhur, por pas shqyrtimit të mëtejshëm të videos, ekspertët sugjerojnë se ndoshta Minochkina në fakt po kryente një formë spiunazhi. Nëse mendoni se kjo është absurde, atëherë duhet të pyesni pse një punonjëse e UNMIK-ut e cila paguhet mirë do të bënte një gjë të tillë, nëse nuk po merrte ndonjë mesazh?

Një shembull tjetër i Rusisë kohët e fundit, duke përfshirë edhe veprimet e inteligjencës ushtarake të saj, ndërhyrja e GRU ishte përpjekja e grushtit të vitit 2016 në Malin e Zi. Disa prej këtyre të dyshuarve u dënuan kohët e fundit për kampanjë për ta përmbysur qeverinë e Malit të Zi dhe tani shohim përpjekjet e dorës së parë të GRU-së në mes të Kosovës, duke përfshirë përpjekjet për t'i ndezur tensionet etnike midis serbëve dhe shqiptarëve dhe pastaj të fshihen pas mbulesës së OKB-së.

Për fat të mirë, për Kosovën dhe pjesën tjetër të Ballkanit, tentimet e GRU-së që t'i shfrytëzojë tensionet midis Serbisë dhe Kosovës kanë dështuar.

**(Autori është zëvendësministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës)**

## Dënohet sulmi fizik ndaj gruas rome në Lipjan



**LIPJAN, 30 MAJ (ER)** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë (KMDLNj) ka dënuar sulmin ndaj një qytetareje me përkatësi rome, e cila ishte raportuar nëpër rrjete sociale dhe disa media elektronike, se "kishte rrëmbyer fëmijë nëpër shkollë".

KMDLNj e ka cilësuar sulmin fizik nga një grup i të rinjve, në qytetin e Lipjanit, si "linçim i një qytetareje të pafajshme". "KMDLNj e dënon ashpër këtë dhunim të të drejtave të njeriut, të lirisë së lëvizjes dhe të drejtës për jetë të një qytetareje të pafajshme, e cila me asgjë nuk e ka provokuar mllëfin dhe dhunën ndaj saj. Njëherësh, KMDLNj kërkon nga organet e

hetuesisë që ky rast të trajtohet me urgjencë dhe të gjithë ata që janë përgjegjës të nxirren para organeve të drejtësisë", është thënë në reagim.

Në komunikatë dënohet ashpër edhe sjellja e disa mediave për shkak të, siç është thënë, "publikimit të lajmit të remë, sipas të cilit, gruaja ishte një 'grabitëse fëmijësh'".

Edhe Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkalinje dhe Egjiptase të Kosovës (RRO-GRAEK) ka dënuar ashpër këtë rast. Këtë rast e ka dënuar edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili ka ftuar organet e rendit t'i sjellin para drejtësisë personat përgjegjës. Policia e Kosovës ka njoftuar se i ka nisur hetimet për këtë rast.

## Në Mitrovicë u shënuar Dita Botërore Kundër Duhanit

**MITROVICË, 30 MAJ (ER)** - Drejtoria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e "31 majit - Ditës Botërore Kundër Duhanit", organizuan një tryezë vetëdijësuese kundër pirjes së duhanit. Në tryezë morën pjesë zyrtarë nga Drejtoria e Shëndetësisë, kryeshefi i QKMF-së, Burim Pllana, kryeinfermiera Rukije Hajdari Pllana, drejtoresha e Institutit të Shëndetit Publik në Mitrovicë, Teuta Fejza, përfaqësues të tjerë të shëndetësisë, drejtorë të shkollave, nxënës, prindër dhe pjesëmarrës të tjerë nga shoqëria civile.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi i qytetarëve rreth dëmeve që shkakton konsumimi i duhanit. Ndërsa kryeshefi i QKMF-së, Burim Pllana, ka theksuar se edhe personat që nuk e pinë duhanin, mund të dëmtohen kur ata ndodhen vazhdimisht në një mjedis ku pihet duhan. Sipas tij, duhani është shkaktari i dytë i vdekjeve në botë, se për çdo vit në botë vdesin rreth shtatë milionë njerëz si pasojë e pirjes së duhanit. Studimet e fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë flasin për atë se nga pesë infarkte, katër shkaktohen nga pirja e duhanit.

Drejtoresha e Institutit të Shëndetit Publik në Mitrovicë,

Teuta Fejza, ka thënë se në këtë ditë në gjithë botën organizohen aktivitete për sensibilizim të qytetarëve për pasojat vdekjeprurëse nga duhani i cili është përgjegjës për shumë lloje të sëmundjeve të rënda që vijnë nga ai. Ajo, po ashtu, ka theksuar se pirja e duhanit shkakton kancer në mushkëri, sëmundje të tjera dhe dëmton fëmijët gjatë shtatzënisë.

Fejza bëri apel që të respektohet Ligji Kundër Duhanit dhe ftoi inspektorët komunalë të dalin në vendet ku konsumohet duhani nëpër objekte të mbyllura dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e ligjit, duk i dënuar ata që e shkelin ligjin.

Ndërkaq doktor Ardian Peci ka



prezantuar një hulumtim të bërë rreth konsumimit të duhanit dhe pasojave të personat që e konsumojnë atë.

Në fund të kësaj tryeze është

zhvilluar një diskutim mes specialistëve të shëndetësisë dhe nxënësve lidhur me pyetjet që kishin për konsumimin e duhanit.

## Shefi i Pentagonit në Azi, mes tensioneve me Iranin, Kinën dhe Korenë e Veriut

WASHINGTON, 30 MAJ - Sekretari i Mbrojtjes në detyrë Pat Shanahan po viziton këtë javë rajonin Azi-Paqësor, një udhëtim që vjen ndërsa tensionet me Iranin janë në rritje. Një kërcënim në rritje vjen nga Lindja e Mesme, ndërsa Koreja e Veriut po teston raketa të reja. Por, sekretari i Mbrojtjes në detyrë thotë se Kina vazhdon të jetë shqetësimi i tij kryesor. "Përparësia ime kryesore është zbatimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Kina është përparësi në këtë strategji", tha

Shanahan.

Turi i tij në rajonin Azi-Paqësor përfshin ndalesa në Hawaii dhe Indonezi, përpara se të marrë pjesë në Singapor në forumin vjetor Shangri-La për mbrojtjen, ku ai pritet të takohet me ministrin e Mbrojtjes së Kinës.

Të dyja vendet janë angazhuar në një luftë tregtare, ndërkohë që forcat e tyre ushtarake përpiqen për ndikim në rajon. "Termi konkurrues pothuajse i barabartë përdoret për Kinën. Mendoj se ky term po vjetrohet. Në shumë

fusha, Kina ka tashmë kapacitete si tonat ose më të mira", thotë Bradley Bowman, i Fondacionit për Mbrojtjen e Demokracive.

Edhe fuqia ushtarake e Kinës po rritet. "Zhvillimi kryesor është se tashmë Kina ka një buxhet të madh ushtarak, teknologji të lartë në veçanti në fushën e elektronikës dhe robotikës, ndoshta edhe për disa lloje raketash. Kina mund të jetë tani tepër konkurruese, sidomos në Paqësorin Perëndimor", thotë Michael O'Hanlon i Institutit "Brookings".



## Deklaratat e Muellerit shtojnë thirrjet për votëbesim ndaj Trumpit

Pasi që këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, i bëri komentet e para publike, demokratët në Shtetet e Bashkuara bënë thirrje për nxjerrjen e presidentit Donald Trump në votëbesim

WASHINGTON, 30 MAJ - Demokratët në Shtetet e Bashkuara bënë thirrje për nxjerrjen e presidentit Donald Trump në votëbesim, pasi këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, i bëri komentet e para publike. Duke folur të mërkurën, Mueller tha se hetimet e tij nuk e kanë shfajësuar Trumpin nga pengimi i drejtësisë.

Muelleri është ngarkuar me hetimin e ndërhyrjes së Rusisë në zgjedhjet presidenciale në ShBA më 2016. Ai tha se akuzat për krim kundër një presidenti nuk kanë qenë opsion. Çështja e votëbesimit e ka ndarë Partinë Demokratike, duke vënë një numër ligjvënësish në kundërshtim me kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, dhe të tjerë. Pelosi deri më tash i ka rezistuar idesë, duke argumentuar se do të ishte kundërproduktive.

Por, komentet e Muellerit i nxitën tre kandidatë të mundshëm për president të ShBA-së nga Partia Demokratike: Cory Booker, Kirsten Gillibrand dhe Pete Buttigieg, t'iu bashkohen thirrjeve për votëbesim. "Kongresi ka detyrim ligjor dhe moral për t'i filluar menjëherë procedurat e votëbesimit", tha Booker, senator

nga Nju Xhërsi.

Senatorja e Nju Jorkut, Gillibrand, tha se "është koha që republikanët dhe demokratët të nisin seanca dëgjimore dhe t'i ndjekin faktet kudo që mund të çojnë". Kryebashkiaku i Indianës, Pete Buttigieg, tha përmes një postimi në "Twitter", se situata është afër "referimit për votëbesim".

Duke iu përgjigjur deklaratës së Muellerit, kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Pelosi, tha se "Kongresi e konsideron të shenjtë përgjegjësinë e tij kushtetuese për ta hetuar dhe mbajtur presidentin përgjegjës për shpërdorimin e pushtetit".

Kryetari i Komitetit Gjyqësor në Dhomën e Përfaqësuesve, Jerrold Nadler, tha se këshilltari i posaçëm nuk e shfajësoi presidentin nga pengimi i drejtësisë. "Në lidhje me çështjen e votëbesimit, në këtë pikë të gjitha opsionet janë në tavolinë dhe asgjë nuk duhet përjashtuar", tha Nadler.

Trumpi tha në "Twitter" se nuk ka pasur prova të mjaftueshme kundër tij. "Dhe, për këtë arsye, në vendin tonë një person është i pafajshëm", tha Trumpi.

Mueller kryesisht konfirmoi atë që thuhet në raportin e tij, i cili është



publikuar muajin e kaluar me disa redaktime. Ai i detajoi dhjetë raste kur Trumpi mund të ketë bërë përpjekje për t'i penguar hetimet, por tha se akuzimi i presidentit për krim nuk ka qenë opsion për këshilltarin e posaçëm.

Mueller tha se nuk beson se është "e përshtatshme të flasë më tej" për hetimet dhe se nuk do të jepte ndonjë informacion që nuk është në raportin e ekipit të tij.

Duke iu përgjigjur thirrjeve të ligjvënësve demokratë për dësh-

mi para Kongresit, Mueller tha: "Raporti është dëshmia ime". Ai gjithashtu njoftoi mbylljen formale të zyrës së këshilltarit të posaçëm dhe dorëheqjen e tij nga Departamenti i Drejtësisë për t'iu kthyer jetës private.

## Përparim në bisedimet mbi krizën në Venezuelë

OSLO, 30 MAJ - Qeveria norvegjeze tha se është duke u bërë përparim në negociatat mes përfaqësuesve të presidentit të Venezuelës, Nikolas Maduro dhe udhëheqësit të opozitës, Juan Guaido. Ministria e Jashtme tha se të dyja palët "kanë treguar gatishmëri të lartë për të ecur përpara" drejt një zgjidhjeje të negociuar për krizën politike në Venezuelë.

Ministri venezuelian i Punëve të Jashtme, Jorge Arreaza, në një postim në "Twitter" tha se ai vlerëson përpjekjet e Norvegjisë

për paqen.

Arreaza tha gjithashtu se të dyja palët "kanë treguar gatishmëri për të lëvizur drejt një zgjidhjeje të negociuar për krizën në Venezuelë".

Presidenti i Venezuelës, Nikolas Maduro, tha se dialogu është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur dallimet e tyre. "Mënyra e vetme është dialogu. U shpenzua shumë energji për të shkuar në Norvegji, pati disa muaj bisedime sekrete, të kujdesshme dhe ne duhet të vazhdojmë kështu, të jemi të kujdesshëm. U deshën

disa muaj për të arritur në Norvegji 10 ditë më parë", tha presidenti i Venezuelës, Nikolas Maduro.

Bisedimet zhvillohen mes tensioneve në rritje mes presidentit Maduro dhe presidentit të Asamblesë Kombëtare të Venezuelës, Juan Guaido, i cili u vetëshpall president i përkohshëm i vendit në janar me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe rreth 50 vendeve të tjera.

Guaido pranoi të bisedonte në Norvegji pasi fillimisht kishte



thënë se çdo dialog duhet të rezultonte me dorëheqjen e

Maduros dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

# Hamburgerët, gjithçka që duhet të dini për ushqimin “amerikan”



Është ushqimi më i popullarizuar në Amerikë, është gjithashtu shumë popullor në Itali dhe ka një histori plot kureshtje. Hamburgeri, (kishte festën e vet, 28 maj, dita botërore e hamburgerit) e ka origjinën në realitetin gjerman.

## Nga “bifteku i Hamburgut” në “zvicrane”: etimologjia e mitit

Hamburger – sipas kurioziteteve të mbledhura nga shoqata jofitim-prurëse Carni Sostenibili, e cila ka si qëllim qëndrueshmërinë e prodhimit të mishit – vjen nga fjala “Hamburg”, që është Hamburgu, qyteti i dytë më i madh në Gjermani. Burger biftek, atëherë vetëm burgers, u shfaq në kronikat kulinare amerikane duke filluar nga gjysma e parë e

shekullit të 19-të dhe ai që e përdori për t’u shërbyer për herë të parë në restorantin e tij në Nju Jork në 1873 është shefi Charles Ranhofer. Etimologjia italiane e termit “zvicrane”, një fjalë me të cilën ishte zakoni të thërrisnim medaljonin e mishit në Itali deri disa dekada më parë, ka pasur origjinën të ngjashme. Zvicra, në fakt, rrjedh nga një pjatë e importuar nga kantoni gjerman i shtetit zvicran.

## Më tregoni se si e thërrisni dhe unë do t’ju tregoj se çfarë hamburgeri të zgjidhni

Ka një zhargon vetëm për adhuruesit e hamburgerëve që përdoren për të përcaktuar variacionet: “slopper” është burgeri i mbuluar me salcë djegëse, “patty

melt” ai me qepë të thata dhe djathë, të mbështjellë në dy feta bukë thekre. Me “lider” ne i referohemi një hamburger të vogël dhe katror të shërbyer në simite klasike, mbuluar me farat e susamit.

## Kush gatuan mirë, ha më mirë

Për gatim të përsosur, shmangni përdorimin e vajit dhe lëreni mishin 10 minuta në temperaturën e dhomës para se të vendosni atë në nxehtësi për të parandaluar që brendësia të mbetet e ftohtë. Hamburgeri, pra, dëshiron një gatim të qetë, dhe nëse vetëm shija mund të udhëheqë zgjedhjen ndërmjet të gatuar mirë të gatuar ose me gjak, metoda nuk komprometohet: mishi kurrë nuk duhet të kthehet vazhdimisht, mjaftojnë 2 deri në 4 minuta për

anë. Dhe si mund ta kuptojmë këtë? Vini re: kur gjysma e trashësisë ka ndryshuar ngjyrën është koha për ta kthyer në anën tjetër. Përfundimisht, është shumë e ndaluar që të shpohet mishi me një pirun, pasi rezultati do të ishte humbja e lëngjeve të çmuara gjatë gatimit. Këshilla për të mos djegur sipërfaqet është ende e vlefshme.

## Prerja dhe mishrat

Nëse nuk ka dyshim se hamburgeri i vërtetë është vetëm me mish viçi, në kohët e fundit janë përhapur variacione të panumërta. Më të dashurit? Pulë dhe mish derri, shpesh i aromatizuar me përbërës të tjerë. Por le të shohim se cilat prerje preferoni që të keni një sanduiç që është gjithmonë i shijshëm. Hamburgeri i gjedhit ‘par excellence’ është marrë nga prerjet e shpatullës me shtimin e

barkut për të pasuruar aromën me pak yndyrë, sepse në fakt hamburgeri më i shijshëm dhe i butë përmban nga 12 deri në 15% të yndyrave që gjatë gatimit shpërndahen. Për ata që duan të bëjnë një zgjedhje të lehtë, prerjet që duhen zgjedhur janë ato të pasme, prerje me një përmbajtje lipidi jo më shumë se 5%.

## Disa numra

Sipas një hulumtimi të kohëve të fundit, pothuajse një në tre italianë pretendon të hajë sanduiç të “stilit amerikan” çdo ditë, dhe 80% thonë se e konsumojnë atë të paktën një herë në muaj. Hamburgerja më e shtrenjtë në botë kushton 1400 euro, është ngrënë në Las Vegas dhe është bërë nga mishi i Kobe, i përzier me karkaleca dhe zhardhok kërpudhash. /Gazeta Shqip



E rrallë

## Një ndërhyrje nga qielli e shpëton shoferin nga gjoba

Një shofer në Gjermani po e drejtonte makinën me 54 km/orë, në një vend ku shpejtësia e lejuar ishte 30 km/orë. Për këtë, ai do të ishte dënuar me 105 euro gjobë por, shoferin fatlum, e shpëtoi një pëllumb i bardhë që fluturoi përpara kamerës duke mbuluar pikërisht fytyrën dhe identitetin e shoferit. Po ashtu, reflektimi i targës bëri që të mos duken numrat.



FOTO E DITES



U.S. Army photo by Sgt. Avery Cunningham (DOD)

Ushtarët e ushtrisë së ShBA-së kryejnë një operacion ajror pranë ishullit të Mont Saint Michel në Francë. / DOD/

E jashtëzakonshme

## Një kështjellë madhështore ku njerëzit jetojnë pa paguar qira

Për më tepër se 800 vjet, mijëra familje kanë jetuar brenda kësaj ndërtese gjigante në mes të shkretëtirës, në shtetin indian të Rajasthanit. E ndërtuar në vitin 1156, kështjella ranore e rrethuar me tri mure të lartë, katër porta gjigante në të gjitha anët e kështjellës, si dhe 99 kulla që përdoren për tanket, duket si të ishte një "kështjellë prej floriri". Ky vend është më tepër sesa një vendndodhje arkitekturale, historike, pasi 800 vjet pas ndërtimit të saj, 2



000 - 4 000 banues jetonin brenda këtyre mureve të kështjellës, pa paguar qira. Kjo tokë u dha nga mbreti i asaj kohe dhe në këmbim duhet t'i shërbenin mbretërisë së tij.

### BARSOLETA E DITËS



Një i burgosur e pyet një tjetër të burgosur:  
- Për çfarë të kanë burgosur?  
- Gjykatësi po thotë se shteti i paska prodhuar disa monedha sikur të miat.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

#### "DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.  
Regjia: Tim Burton



#### Ne ora 16:00 dhe 19:00 "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.  
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

#### "EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.  
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

#### "THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



**DASHI**

Sot do ta keni mundësinë

t'i analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitet.



**DEMI**

Idetë që keni duhet t'i vini në

veprim dhe t'i zhvillonin. Problemi i vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.



**BINJAKËT**

Dikush po mundohet t'ju verë

shkopinj nën rrota sot. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm do të dini si të dilni nga kjo situatë.



**GAFORRJA**

Mund t'i lini gjërat të rrjedhin vetë. E

rëndësishme është që në një çast të caktuar ju do ta keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.



**LUANI**

Hap pas hapi do të arrini të

mblidhni dhe ju sukseset tuaja. Shijoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.



**VIRGJËRESHA**

Në varësi të

humorit do ta keni edhe sjelljen sot. Por, personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.



**PESHORJA**

Jeni vëzhgues të mençur

dhe sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.



**AKREPI**

Sot nuk duhet të ekzagjeroni

heni në kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkonin mund të kenë kushtet për t'u realizuar.



**SHIGJETARI**

Mos kërkonin aventura sot sepse

nuk do të mund ta përbaloni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.



**BRICJAPI**

Indiferenca në shumë raste është

arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon çaste të dhimbshme që mund të na lëndojnë.



**UJORI**

Konsideroni atë që ju thotë

instinkti juaj i pagabueshëm sot. Mund të jetë çasti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.



**PESHQIT**

Keni shumë çështje për të

zgjidhur gjatë ditës së sotme. Pjesa e parë e ditës do të ketë aktivitetet të shumta. Më e qetë mbrëmja.

## Çifti Bieber në formë të përkryer



**A**ta zbukuruan faqen e parë të "Vogue"-s në muajin mars. Justin Bieber dhe gruaja e tij Hailey Bieber u dalluan veçmas në Los Anxhelos të mërkurën, duke

kthyer kokat e të gjithë atyre që kishin afër. Justini tregoi se si e mban fizikun, ndërsa Hailey u shfaq për bukuritë me një xhakëtë blu.

## Lana Del Rey shfaqet pa grim



**A**jo është një nga këngëtalet më të famshme në botë. Lana Del Rey ka shkëlqyer me bukurinë e saj natyrale pasi këngëtarja u shfaq pa grim derisa po shkonte në kishë në

Beverly Hills. Përveç që ajo u shfaq pa grim, 33-vjeçarja ishte parë e veshur mjaft thjesht me pantallona të shkurtra dhe një xhemper ngjyrë kremi.



## Kimi debuton me stil të ri flokësh

**T**rendit të flokëve të shkurtra i është bashkuar edhe Kim Kardashian. E famshmja 38-vjeçare është fotografuar nga paparacët teksa po dilte nga një veturë, e veshur me rroba të markës së bashkëshortit të saj,

Kanye West, ku tek tutat shihet mes të tjerash edhe mbishkrimi "Besojini Zotit". Kimi gjatë këtij muaji është bërë nënë e fëmijës së saj të katërt, djalin Psalm, i cili erdhi në jetë falë një nëne surrogate.

## Moore e pranon se nuk paguhet njëjtë si aktorët meshkuj



**J**ulianne Moore e ka pranuar se ka ende shumë punë që femrat të paguhet njëjtë si kolegët e tyre meshkuj në Hollywood. Kur u pyet në një intervistë për "The Telegraph" nëse paguhet njëjtë, fituesja e çmimit Oscar u përgjigj:

"Oh jo! Përfundimisht jo! Pavarësisht faktit se 58-vjeçarja është aktore e mirënjohur, Julianne e pranoi se ende ka "hierarki" të përfshirë në filma të zakonshëm, që është një sfidë e madhe kur bëhet fjalë për mospërputhjet në paga.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**SPORT**

QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**



TEL: 045 82 82 82

# Thaqi: Ishte kampionat pozitiv për Flamurtarin

Sigurimi i mbijetesës pa barazh dhe grumbullimi i 45 pikëve ka bërë që trajneri Arsim Thaqi ta vlerësojë kampionatin e sapopërfunduar si të suksesshëm për Flamurtarin. "Për mua si trajner dhe për Flamurtarin si klub ka qenë një kampionat i suksesshëm, pasi arritëm ta sigurojmë mbetjen në elitë, pa pasur nevojë të luajmë në barazh. Po ashtu, kemi krijuar një ekip të mirë ani pse nuk kishim shumë emra në ekip. Flamurtari edicionin e kaluar e siguroi mbijetesën nëpërmjet barazhit dhe kishte 25 pikë, kurse sivjet pa barazh dhe grumbulluam 45 pikë", ka thënë Thaqi



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 MAJ - Trajneri Arsim Thaqi e ka vlerësuar edicionin 2018/2019 të suksesshëm për skuadrën e Flamurtarit, por edhe në aspektin personal. Trajneri Thaqi ka thënë të enjten për "Epokën e re" se sukses mund të quhet fakti se skuadra kuqezi nuk kishte nevojë të luajë në barazh dhe grumbulloi njëzetë pikë më shumë sesa në sezonin paraprak. "Për mua si trajner dhe për Flamurtarin si klub ka qenë një kampionat i suksesshëm, pasi arritëm ta sigurojmë mbetjen në elitë pa pasur nevojë të luajmë në barazh. Po ashtu, kemi krijuar një ekip të mirë ani pse

nuk kishim shumë emra në ekip. Flamurtari edicionin e kaluar e siguroi mbijetesën nëpërmjet barazhit dhe kishte 25 pikë, kurse sivjet pa barazh dhe grumbulluam 45 pikë", ka thënë Thaqi. Ish-trajneri i 2 Korrikut dhe Trepçës '89 ishte trajner dhe më pas drejtor në skuadrën e Prishtinës, por në verën e kaluar u largua nga "bardhekaltrit" për t'iu bashkuar skuadrës tjetër nga kryeqyteti, Flamurtarit. Pavarësisht prej organizimit të vonshëm dhe ambicieve jo të mëdha, Thaqi për disa javë e mbajti Flamurtarin në krye të tabelës, duke i mahnitur të gjithë me rezultatet e arritura. Ai ka treguar për gazetë se kontrata i përfundon në qershor, por nuk e përjashton

mundësinë që edhe në edicionin e ri t'i prijë skuadrës së Flamurtarit. "Ne ende jemi duke i vazhduar stërvitjet, kurse kontrata ime me këtë klub është deri në qershor. Normalisht se shumë herët. Duhet të ulemi dhe të bisedojmë me drejtuesit e Flamurtarit për ta parë mundësinë se a do ta vazhdojmë bashkëpunimin apo jo. Kam kaluar gjatë kësaj kohe mirë me lojtarët dhe kryetarin e klubit, prandaj do t'i jap përparësi Flamurtarit edhe nëse më vjen ndonjë ofertë serioze. Nëse nuk gjejmë gjuhë të përbashkët me Flamurtarin, më mbetet t'i shikoj mundësitë e tjera", ka deklaruar Thaqi. Flamurtari kampionatin e mbylli në pozitën e pestë me 45 pikë.

## SHKURT

### Batatina: Pas 3 qershorit zyrtarizojmë transferimet

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka konfirmuar, nëpërmjet një postimi në "Facebook", se nga data 3 qershor skuadra e Llapit do ta fillojë zyrtarizimin e transferimeve dhe vazhdimin e kontratave me futbollistët aktualë. "Së bashku me kryetarin e Klubit u morëm vesh që nga data 3 qershor t'i fillojmë zyrtarizimet e transferimeve të reja dhe vazhdimin e kontratave të lojtarëve që dëshirojnë t'i qëndrojnë besnikë klubit dhe qytetit të Podujevës", ka shkruar Batatina. "Prapë do të jemi skuadër që do të luftojmë për trofe sepse këtë e meriton qyteti i futbollit, Podujeva", ka shtuar Batatina.

### Xhaka, tifozëve: Më dhemb që nuk jua sollëm trofeun

Mesfushori Granit Xhaka është i dëshpëruar që nuk arriti t'ua sjellë Kupën e Ligës së Evropës, tifozëve të Arsenalit. Kjo e fundit pësoi humbje të thellë nga Chelsea (4-1). "Vërtet dhemb që ne nuk ia dolëm ta sjellim në shtëpi këtë trofe. Faleminderit të gjithëve që erdhën në Baku. Faleminderit të gjithë tifozëve për përkrahjen këtë sezon", ka shkruar Xhaka në "Facebook".

### Feronikeli, prioritet i Islamit

Mbrojtësi Përparim Islami është shpallur me Feronikelin kampion dhe fitues i Kupës. Kontrata e tij me skuadrën nga Drenasi përfundon në muajin qershor, por Islami nuk e përjashton mundësinë të jetë pjesë e "Niklit" edhe në edicionin e ri. "Kontrata ime përfundon në fund të qershorit. Nuk e di çka të them. Sigurisht se prioritet do t'i jap Feronikelit pasi këtu kam kaluar jashtëzakonisht mirë, por do të të shohim pas kupave të Evropës për të ardhmen time", ka thënë Islami për "Telegrafi".

## Gjilani siguron Superligën, Besa edhe një vit në Ligën e Parë

Prishtinë, 30 maj - Skuadra e Gjilanit e ka fituar ndeshjen e barazhit ndaj Besës (1-0) dhe në këtë mënyrë e ka siguruar mbetjen në IPKO Superligë edhe për

edicionin 2019/2020. Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri" e shënoi Keita Razak në minutën e 24-t. Për Gjilanin

është një sukses, pasi edhe përkundër disa problemeve, arriti mbetjen në elitë, kurse Besa, që është ndër skuadrat me traditë në Kosovë, do të duhet të

bëjë gara edhe një vit në Ligën e Parë. Skuadra tjetër që e siguron Superligën do të mësohet të shtunën kur takohen Trepça '89 dhe Vëllaznimi.





## Pacolli: Zekaj te Kosova, falë Vokrrit

**PRISHTINË, 30 MAJ** - Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, e ka përshëndetur vendimin e Arton Zekajt që të përfaqësojë Kosovën. Zëvendëskryeministri Pacolli e ka falënderuar futbollistin e Lille që iu përgjigj ftesës së legjendës Vokri dhe pritjeve të futboll-

dashësve të Kosovës për ta veshur fanellën e "dardanëve". "Kënaqësi e pafund që të vazhdojmë aty ku e la legjenda e futbollit të Kosovës, Fadil Vokri. Para dy vjetësh, Vokri në emër të Kosovës iu pat drejtuar Arton Zekajt, ish-kapiteni i U16 dhe U17 të Serbisë, duke e ftuar që t'i bashkohet kombëtares së Kosovës. Artoni është aktiv në

futboll që nga moshja gjashtëvjeçare, duke iu bashkuar në fëmijërinë e hershme Akademisë së Futbollit të Partizanit. Pas shumë kërkesave të shumë klubeve evropiane, Artoni i është bashkuar nënkampionit të Francës, Lille, përderisa FIFA ka lejuar që Artoni t'i bashkohet U21 të Republikës së Kosovës. Tani

është momenti që ky i ri, yll në ngritje, të shkëlqej në Lille, Francë, si dhe në vendin e tij Kosovën. I ri, shtatlathtë, i shpejtë, i fuqishëm, me talentin e rrallë në lojë në mesfushë, Zekaj do të jetë një shtyllë lidhëse mes mbrojtjes dhe sulmit të kombëtares sonë. E falënderoj nga zemra që iu përgjigj ftesës së legjendës Vokri dhe pritjeve të



futbolldashësve të Kosovës", ka shkruar Pacolli në "Facebook".

# Mavraj: Reja është si babai ynë

**TIRANË, 30 MAJ** - Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, është rikthyer në kampionat kuqez. Ai ka folur para medieve për shumë çështje, përfshirë edhe trajnerin e ri Edy Reja. "Duket simpatik, i qetë. Është si babai ynë. Është i buzëqeshur dhe i sjellshëm. Nga ana taktike nuk e vlerësoj dot ende", ka thënë Mavraj.

### Rikthim pas pezullimit, shumë gjëra kanë ndryshuar...

**Mavraj:** Ka ndryshime të rëndësishme. Më duhet pak kohë t'i analizoj këto ndryshime dhe ende nuk mund të jap një mendim, si ka ndryshuar për mirë apo keq. Gjëja e parë që më bëri përshtypje ishte grupi i madh. Kur u futa nuk e gjeta ulësen time. Para ndeshjes me Skocinë kemi qenë të fokusuar. Tani kemi ardhur nga kampionati. Disa lojtarë kanë probleme. Ende nuk e kemi përqendrimin.

### Përshtypjet e para për Rejën?

**Mavraj:** Duket simpatik, i qetë. Është si babai ynë. Është i buzëqeshur dhe i sjellshëm, nga ana taktike nuk e vlerësoj dot ende.

### Koha në Greqi?

**Mavraj:** Ka kaluar shumë kohë, i kam harruar. Besoj se ka qenë përvojë e mirë për mua. Jashtë futbollit ka qenë periudhë e mirë, kam njohtur dhe shumë shqiptarë. Për sa i përket futbollit kanë qenë shumë dallime të mëdha mes futbollit gjerman. Nuk i përballoja dot.

### Ku do të jeni sezonin e ardhshëm?

**Mavraj:** Do të jem maksimalisht i fokusuar dhe i motivuar. Ku do të luaj nuk është vetëm në dorën tonë. E ndiej veten mirë dhe do ta gjejmë zgjidhjen e duhur. Nuk ka qenë vetëm dështim. Erdha në janar te ekipi ku jam dhe duke pasur



parasysh këta gjashtë muajt e mia, nuk ka qenë një vit jo i pasuksesshëm pavarësisht rënies nga kategoria. Kanë ndodhur shumë gjëra, por për mua ka rëndësi që i dola zot kësaj situatë. E kalova këtë fazë me vetëbesim.

### Mund të jemi në ato nivele që kemi qenë?

**Mavraj:** Liga e Kombeve na eci keq. Të gjithë s'kemi qenë të kënaqur me paraqitjet tona. Po u përmirësuam nga loja do të vijmë edhe rezultatet. Ka pasur shumë ndryshime kohët e fundit. Duhet të afrohem edhe më shumë njëri me tjetrin. Rezultati vlen në futboll, nuk e kemi pasur, por i kemi cilësitë. Është çasti i duhur për ta lënë të kaluarën pas. Do të kemi një shans të vërtetë.

### Si do t'i këshillonit shokët për takimin e Islandës?

**Mavraj:** Edhe në kohën e Canës, ka

qenë ekip homogjen, i fortë, 11 luftëtarë. Grupi si grup e ka përgjegjësinë për ta ndihmuar njëri-tjetrin. Tani që nuk do të jem në fushë, këtë ndeshje, do t'u jap vetëbesim. Do të na shërbejë të gjithëve për të ardhmen. Çdo ekip i suksesshëm ka 11 liderë, nuk është vetëm 1.

### Është i vështirë qershor për të për-gatitur një ndeshje?

**Mavraj:** Besoj se ka dallim të madh. Ndashja në qershor ka rëndësi nëse është miqësore apo për pikë. Në fund të kampionatit gjithçka mbyllet dhe e ke të vështirë të luash prapë. E kemi të vështirë të fokusohemi. E presim me kënaqësi grumbullimin. Në qershor gjithmonë kur kemi pasur miqësore kanë qenë katastrofë. Premtimi kryesor do të jetë që do të mundohemi me shpirt e me gjithë dëshirë t'i kënaqim të gjithë.

## SHKURT

### Lenjani: Panucci nuk mund të jetë më shumë shqiptar se unë

Anëtori i Sionit, Ermir Lenjani, u rikthye në kombëtare pas largimit të Christian Panuccit. Edhe pse nuk ka dëshirë të flasë për të shkuarën, futbollisti kuqez i thumbon ish-trajnerin me deklaratën e tij teksa thekson se Panucci nuk mund të jetë kurrë më shqiptar se ai. "Nuk dua të flas shumë për atë letër. Të gjithë e kanë parë çfarë kam menduar dhe çfarë kam thënë. Nuk dua të flas për Panuccin. Ishte vendim shumë i vështirë dhe më ka ardhur shumë inat që nuk isha në kombëtare. Të them të drejtën, Panucci nuk mund të jetë më shumë shqiptar se unë. E kam pasur fanellën veshur deri tani, ndaj ka ndodhur diçka e tillë", ka thënë Lenjani. "Nuk e kam kuptuar as unë. Kam bërë një sezon mjaft të mirë dhe me ndeshje të mira edhe nuk isha në grumbullim. Nuk dija si ta shpjegoja. Vendosa të qëndroja i qetë dhe ajo që ndodhi me Panuccin është lënë pas. Ka qenë në Cyrih dhe kemi takuar edhe të tjerë lojtarë. Kemi pasur një bisedë mjaft të mirë. Më ka treguar çfarë mendimi ka dhe kemi folur", ka shtuar Lenjani.

### Pedro vendos dy rekordet historike

Sulmuesi i skuadrës së Chelseat, Pedro, është cilësuar njeriu i finaleve. Me triumfin ndaj Arsenalit, 31-vjeçari regjistroi dy rekorde personale. Spanjollu u bë lojtari i parë që fiton Kupën e Botës, Kampionatin Evropian, Ligën e Kampionëve, Ligën e Evropës, Botërorin e Klubeve si dhe Superkupën e Evropës. Pedro ka fituar kështu çdo kompeticion të mundshëm, teksa askush nuk e ka arritur suksesin e këtij futbollisti. 31-vjeçari është gjithashtu lojtari i parë në histori që ka shënruar në tri finale evropiane për klube. Sulmuesi ka arritur ta dërgojë topin në rrjetë në finale të Ligës së Kampionëve, Ligën e Evropës dhe Superkupës së Evropës.

### Interi largon Spallettin, Conte shumë afër

Po përflitej prej kohësh dhe tashmë është zyrtarizuar gjithçka. Me një postim në llogarinë zyrtare në "Twitter", Interi ka njoftuar se Luciano Spalletti nuk do të jetë më trajner i ekipit zikaltër. Diçka e tillë ishte paralajmëruar dhe nga mediat, pasi Antonio Conte është përfolur shumë si trajner i ri i Interit dhe largimi i Spallettit dukej i paevitueshëm. Kështu, italiani largohet pas 2 sezonesh në krye të zikaltërve.

### Sarri: Tani koha të flasë me Chelsean

Trajneri italian Maurizio Sarri ka konfirmuar se këto ditë do të diskutojë me klubin e Chelseat rreth të ardhmes së tij. Në sezonin e tij të parë me klubin anglez, Sarri arriti ta fitojë Ligën e Evropës dhe të kualifikohet në finale të League Cup, megjithatë e ardhmja e tij nuk është e sigurt. "Pas çdo sezoni flas me pronarin dhe drejtorin, kjo është normale. E dini shumë mirë që e dua Premierë Ligën, jam me fat që jam te Chelsea. Tani duhet të flas me klubin, duhet ta dimë se çfarë mund të bëjë klubi për mua dhe çfarë unë për klubin", ka thënë Sarri, i cili është lidhur me një kalim te Juventusit në këtë afat kalimtar.

## Lamtumira e hidhur dhe e përloitur e Cechut

Finalja e Ligës së Evropës në Baku ishte jo vetëm e lamtumirës së Eden Hazardit nga Chelsea. Lotët e një miti tjetër rrodhën nga sytë. Ai që i tha lamtumirën futbollit ishte Petr Cech. Gjiganti çek, në moshën 37-vjeçare, i "var dorëzat në gozhdë". Dhe e bëri këtë me një humbje të dhimbshme, që koinçidoi me bal-

lafaqimin mes dy ekipeve të tij të zemrës, Chelsea dhe Arsenal. Çeku ka 15 sezone, që është një nga portierët e spikatur në futbollin anglez. Një klasik i garave ndërkombëtare, një nga emrat e paharruar, kur të kërkohet t'i thërrasësh në kujtesë portierët më të mirë. Cech i tha lamtumirë futbollit të luajtur, duke lënë pas

një karrierë mbresëlënëse falë cilësive të mëdha. Ndoshta nuk do ta dëshironte një fund të tillë, duke pësuar katër gola në një finale të rëndësishme, por nuk mund të bënte thujasë asgjë në to. Ai e bëri punën e tij, por pjesa tjetër nuk e shoqëroi. Dhe titulli u "zhduk", kaloi te blutë e Londrës. Në fakt, portieri e fitoi

Ligën e Evropës në vitin 2013, pikërisht me Chelsean, sikurse Ligën e Kampionëve një vit më parë, me të njëjtin ekip. Nuk harrohen titujt e kampionit në Premierë Ligë, as pjesëmarrjet në katër kampionate evropiane. Lotët e shënjuan fytyrën e gjigantit çek, sepse Cech, siç ka treguar gjithmonë, përveçse

portier i madh, është një profesionist i patëmetë. Dhe humbja gjithmonë dhemb, kur e përjeton me pasion të madh punën tënde. Tani do të jetë radha e tij për t'u kthyer në "Stamford Bridge", ku e pret pozicioni i drejtorit sportiv. Pa u kursyer, me të njëjtin profesionalizëm, si gjithmonë.



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"**  
 Ukshin Kovaçica Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

30 maj 2019

Në bazë të nenit 19, pika 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 30.5.2019, mori vendim për të shpallur:

**KONKURS**  
 për Rektor të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"

**Kandidatët për rektor duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:**

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asocuar ose profesorit asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

**Procedura e përzgjedhjes:**

- Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
- Zgjedhja e rektorit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës, si dhe nenit 16 të Rregullores për punën e Këshillit Drejtues.
- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit, për shkak të konfliktit të interesit aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**Kërkesës për aplikim, kandidatët duhet t'ia bashkëngjisnin këto dokumente:**

- Biografinë e shkurtër,
- Certifikatën e lindjes,
- Vendimin/certifikatën ekuivalente të titullit akademik,
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxhuese,
- Dëshminë që nuk është nën hetime.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 09:00-15.30, në Zyrën e arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe duhet t'ia adresohen Komisionit profesional të Senatit të Universitetit të Mitrovicës.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (të skanuara), në adresën [konkursi\\_rektorit@umib.net](mailto:konkursi_rektorit@umib.net).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat e shkruara dhe elektronike, përkatësisht nga data 31.5.2019 deri më 14.6.2019, në orën 15.30.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije -**  
**Ministry of Trade and Industry**

**NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E KONKURSIT**

Vazhdohet konkursi i jashtëm i publikuar me datë 16.05.2019 (Epoka e Re) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pozita **Zyrtar për mallra me përdorim të dyfishtë**.

Meqë pas datës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik, afati për pranimin e aplikacioneve për këtë pozitë zgjatet për shtatë (7) ditë kalendrike.

Vazhdimi i konkursit fillon nga: 31.05.2019.

**OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA**

Produžava se javni konkurs koji je objavljen 16.05.2019 (Epoka e Re) u Ministarstvu Trgovine i Industrije, pozicija: **Službenik za robu dvostruke namene**.

Pošto nakon poslednjeg datuma prijema prijava nije postignut prihvatanje balansiranog broja prijava sa etničkog stanovišta, rok za prijem aplikacija za ovu poziciju produžava se na sedam (7) kalendarskih dana.

Produženje konkursa pocinje od 31.05.2019 datuma.

**Lumë's Details**  
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: "Rilindja"

Komuna: Drenas

Data: 31.05.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/011-CS/1.3	Trajnim: Gjithëpërfshirja

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Rilindja", Drenas

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: Gjithëpërfshirja

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)


**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).


Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Rilindja", Drenas më së largu deri më datën; 11.06.2019

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**  
**Personi kontaktues: Arsim Avdyli**  
**Telefoni: 044/402-602**  
**E-maili: arsimavdyli08@gmail.com**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit të Komunës**  
Udhëheqësi i Personelit/Rukovodilac Personal/Head of Personnel

Nr. 111/2019-0030794/19  
Skenderaj, më 30 Maj 2019.

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitë e lira për një, Zyrar për Energjetikë UNM/100 JP00039466, me 30 Maj 2019, vendosi të shpallë këtë:

**K O N K U R S**

Për plotësimin një (1) vendi të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

**Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Urbanizëm.**  
Pozita e punës: Zyrar për Energjetikë.  
Numri i Ekzekutivesve 1.  
Kodi Buxhetor: 66620  
Kategoria funksionale: Profesional 2  
Grada e vendit të punës: Koficienti 7.  
Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.  
Raporton: të Udhëheqësi i Sektorit të Urbanizmit.  
Vend ndodhja :Drejtoria për Urbanizëm , Komuna Skenderaj.

**-Përshkrimi i detyrave të punës :** bën raporte të bilancit të konsumit të energjisë në nivel lokal, krijimi i data bazës për të dhënat mbi konsumin e energjisë në nivel lokal , sipas sektorëve konsumin familjar, konsumin industrial ,konsumimin komunikacionit, të bujqësisë etje, grumbullon, përpunon dhe përgatit dokumentacionin teknik të shfrytëzimit të resurseve Energjettike, merr pjesë në hartimin e Strategjisë dhe Programin e Zbatimit të Strategjisë për energjinë elektrike, merr pjesë në përgatitjen dhe hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar për sektorin, harton raporte të rregullta për të dhënat e bilancit të resurseve minerale Energjettike, kryen edhe detyra tjera që dalin nga legjislacioni për sektorin energetikës.

**Kualifikimi: Përgatitja profesionale:** Diplomë Universitare se paku 2 vite përvojë pune  
- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:  
- Një CV të shkurtër.  
- Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.  
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnikë.  
- Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.  
- Njohja e gjuhëve zyrtare.  
- Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullorës të MAP/DASHC nr. 02/2011.

**Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjeshin këto dokumente:**  
- Diplomë Universitare Fakulteti Elektroteknikë, Juridik, Ekonomik se paku 2 vite përvojë.  
- Dëshmi për përvojën e punës.  
- Certifikata e lindjes.  
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.  
- Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.

Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore  
"Shërbimi Civil i Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, i cili i mirëpret të gjitha aplikacionet nga meshkujt dhe femrat të të gjitha komuniteteve të Kosovës" Aplikacionin mund të merrin në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderajt. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderaj, në kopje dhe mbetet në arkiv nuk kthehet, konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh, që nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditshme dhe në web-faqen e Komunës. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që vijnë pas afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. Konkursi do të shpallet në të dy gjuhët.

Udhëheqësi i Personelit  
Armend Gruda

**Kërkesa për shprehje të interesit**  
Emri i shkollës: "Naim Frashëri"  
Komuna: Drenas  
Data: 31.05.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/010-CS/1.4	Trajnim: Gjithëpërfshirja

